



HYRJE FILOZOFIKE NË PARIMET ISLAME

ZOTI, PEJGAMBERI, MESAZHI

MUHAMMED BAKIR SADËR

DEDIKUAR

Martirëve muslimanë dhe martireve
muslimane në Bosnjën islame!

“E për ata që u mbytën në rrugën e All-llahut, mos thoni: “Janë të vdekur”. Jo, ata janë të gjallë, por ju nuk e kuptoni (gjallërinë e tyre).” (El-Bekare, 154)

Muhamed Mustafa

DISA FJALË TË SHKURTRA

Muhammed Bakir Sadër paraqet figurë markante në kulturën dhe civilizimin islam bashkëkohor, e posaçërisht në lëmin e filozofisë islame.

Ai nuk njihet në botë si propagandues i shi'izmit dhe idesë duodecimaliste por si dashamir dhe propagandues i të vërtetës islame, si në aspektin filozofik, ashtu edhe në atë politik, ekonomik dhe jurist.

Sot në mënyrë të qartë vërejmë se Islami ballafaqohet me rryma të ndryshme botërore pseudoscientike dhe është aksiomatike që të ndërmarrë ndonjë masë defansive.

Në këtë vepër vërejmë se autori e mbron afinitetin e Islamit me argumente shkencore dhe racionale, duke u mbështetur në metodën induktive. Kështu jo vetëm që argumenton vërtetësinë logjike të Islamit por konfirmon edhe relacionin e ngushtë mes metodave shkencore dhe atyre islame.

Sipas dëshmisë së vet Muhammed Bakir Sadrit, ky punim ka filluar të përpilohet si hyrje në veprën e tij kapitale juriste “Fetvat e qarta” në vitin 1976, dhe është përfunduar në vitin 1977.

Muhammed Bakir Sadri e ka përfunduar këtë punim në ditën e cila vlerësohet tepër nga ana e shiitëve muslimanë dhe ka prapavijë historike islame. Kjo ditë njihet si Dita e ngushëllimit, për shkak të rikujtimit të vrasjes së Husein ibën Aliut, nipit të të Dërguarit të Zotit, Muhammedit a.s.

Pra, kjo ditë njihet si “Dita e ashurasë”.

Për t’u kuptuar filozofia e tij, propozoj që të lexohet libri i Henry Corbenit “Historia e filozofisë islame”, pastaj librat e vet autorit: “Bazat e logjikës induktive”, “Ekonomia jonë”, “Filozofia jonë”, “Shkolla Kur’anore”, “Fetvat e qarta” si dhe libri që është para syve tuaj.

Gjatë përkthimit të ajeteve të Kur’anit, jam mbështetur në përkthimin e H. Sherif Ahmetit të botuar në Prishtinë 1988.

Dhe në fund, me zemërgjerësi do të pranoj çdo këshillë apo vërejtje nga lexuesit tanë të sinqertë, sepse perfeksioni i takon vetëm Zotit të Madhëruar.

Paqja e Zotit qoftë mbi ne!

Muhamed Mustafa

FJALA JONË

Madhërueshmëria e njerëzve varet nga idetë e reja, njohuritë moderne dhe metodat e shëndosha të cilat i dhurohen shoqërisë dhe që distribuohen në mesin e tyre, si dhe nga zbulimet e aspekteve të fshehta shkencore nga ana e dijetarëve dhe të të interesuarve për kulturë.

Veç ka përfunduar koha e Aristotelit, Platonit, Ibën Sinasë, Farabiut, Raziut... që konsideroheshin si gjigantë të mendimit dhe pionierë të krijimit e hulumtimit pas studimit preciz dhe tejkallimit të fortifikatës së natyrës për t'i nxjerrë të vërtetat e reja e të përkryera, që nuk i ka arritur asnjë më parë. Ata gjithashtu, ishin themelues të shkencës e kulturës, prijës të dijetarëve dhe mendimtarëve në historinë e njeriut.

Në çdo kohë shkëlqejnë drita dhe mendimi i trurëve viganë në shoqëri dhe i shpiejnë në përparim e progres.

Zotëriu ynë dhe martiri Muhammed Bakir Sadër, i cili ka shkruar në lëmi të ndryshme shkencore dhe ka bërë hulumtime të shumta aq sa rrallëkush mund të bëjë një hap të tillë, konsiderohet si gjigant i shkëlqyer në mendimin islam.

Ka shkruar në fikhun islam, usuli fikh dhe e ka studiuar aq thellë saqë dijetarët muslimanë e kanë konsideruar si argument.

Gjithashtu, ka shkruar për filozofinë evropiane dhe atë orientale, i ka kritikuar e komentuar idetë dhe artet e tyre me argumente bindëse, ka shkruar për ekonominë kapitaliste dhe atë socialiste duke i destruktuar pikat dhe parimet e tyre; ka shkruar për induksionin dhe influencën e tij në shkencat natyrore duke i krahasuar me metodat tjera që e studiojnë krijimin e tokës dhe qiellit me pikënisje nga hulumtimet matematikore.

Pasi që një grup besimtarësh ka kërkuar të botohen fetvatë e tij, ai i është përgjigjur dëshirës dhe kërkimeve të tyre për botim dhe i ka titulluar “El-Fetava el Vadiha” (Fetvatë e qarta), dhe më vonë, pas kërkimit të sërishëm që të shkruaj një hyrje në parimet islame, ka përpiluar një prolegomenë të shkurtër dhe ia ka bashkangjitur veprës së tij, të botuar për të dytën herë “Fetvatë e qarta”.

Dhe ja, unë sot, këtë libër të vogël por me vlerë të madhe ia ofroj rinisë bashkëkohore dhe gjeneratës së re, duke shpresuar se do të zgjohen nga hutimi i tyre dhe do t'i kthehen rrugës së drejtë e të vërtetë, udhëzimit dhe dritës.

Zoti më shpërbleftë!

Botuesi

HYRJE

Disa dijetarë të njohur, një numër i madh i studentëve tanë së bashku me besimtarë të tjerë, kërkuar prej meje të mbështetem në dijetarët tanë të hershëm dhe të shkoj pas gjurmëve të tyre të famshme, për të përpiluar një temë të cilës dita më ditë i rritet vlera.

Ata zakonisht këta shembuj ua kanë bashkangjitur traktateve të tyre shkencore ose u kanë parapri me ndonjë hyrje të shkurtër apo të gjerë, për ta konfirmuar Krijuesin si dhe parimet themelore fetare, sepse punimi shkencor paraqet një hulumtim të lirë racional për rregullat e sheriatit islam, që ia ka dërguar Zoti i Madhëruar Pejgamberit të fundit, të dërguar si mëshirë për botërat.

Ky komentim, në realitet, mbështetet në ato parime.

Pra, besimi në Zotin Dërgues, Pejgamberin e dërguar dhe mesazhin e dërguar, formon rregullën e përgjithshme të çdo punimi shkencor dhe të argumentimit të ndierjes së nevojës për to.

Këtë kërkesë e realizova duke u mbështetur në bindjen se këtu përfitohet kënaqësia ndaj Zotit të Madhëruar dhe se nevoja për një gjë të tillë është e madhe.

Por, u ndesha me pyetjen: “Si do ta shkruaj këtë hyrje? A duhet të jetë e qartë dhe e thjeshtë, ashtu siç është: “El-Fetava el Vadiha”, për ta kuptuar secili që e kupton rregullën e sheriatit?”

Kam vërejtur se ekziston dallimi esencial mes kësaj hyrjeje të propozuar dhe “El Fetava el Vadiha”.

Fetava paraqet vetëm një vështrim për rezultatet e ixhtihadit dhe deduksionit analogjik pa kurrfar argumentimi apo dialogu, kurse për hyrjen e kërkuar nuk mjafton vetëm një pasqyrë por patjetër të argumentojmë, sepse sipas sheriatit, bindja në parimet e fesë, konsiderohet obligim dhe se qëllimi i kësaj hyrjeje është të përforcuarit e bazave dhe parimeve të fesë.

Ky përforcim realizohet vetëm me argumentim të shkallëzuar, por me kusht që çdo shkallë, bile edhe ajo më e thjeshta, të jetë bindëse.

Do të mjaftonte për njeriun që i mbështetet instinktit, edhe lloji më i thjeshtë argumentativ, që konfirmon Krijuesin, për të besuar:

“A mos u krijuan prej kurrëgjësë, apo ata vetë janë krijues?” (Et-Tur:35)

Por mendimi bashkëkohor, qysh para dy shekujsh, nuk e ka lënë këtë instinkt të pastër e të lirë. Për atë që e njeh mendimin modern dhe metodat e tij në hermeneutikë, ndihet nevoja e argumentimit, për shkak të plotësimit të zbrazëtirave, të cilat nuk do të kishin nevojë për argumentim më të thjeshtë dhe më aksiomatik, po që se ndiqej instinkti i lirë.

Para meje kisha dy alternativa: ose të shkruaj për ata të cilët jetojnë ende me instinkt të lirë, janë të larguar nga kënaqësitë e mendimit modern dhe në rast të tillë do të mjaftonte vetëm argumentimi i thjeshtë dhe teksti do të ishte i qartë e i kuptueshëm për pjesën dërrmuese të lexuesve të “El Fetava el Vadiha”, ose të shkruaj për ata, në të cilët ka ndikuar mendimi modern apo kanë studiuar brenda suazave të tij, për ta njohur teozofinë.

U binda se më mirë do të ishte për alternativën e dytë dhe ashtu veprova.

Përgjithësisht u orvata të jem sa më i qartë, të shkruaj me një stil të studentit të zgjuar universitar, të largohem nga shprehjet dhe gjuha e matematikës sipas mundësisë dhe t'i tejkaloj problemet e komplikuara.

Në të njëjtën kohë, e kam respektuar të drejtën e lexuesit të shkathët dhe në mënyrë koncize kam cekur disa çështje të rëndësishme e që janë të analizuara më thellë në librat e mi të tjerë, si psh: parimet e induksionit në logjikë.

Gjithashtu, ia kam mundësuar lexuesit të nivelit më të ulët intelektual, të gjejë në kapitujt e këtij libri furnizimin intelektual e të kuptueshëm dhe argumentimin bindës.

Hapi i parë i argumentit shkencor induktiv për konfirmimin e Kreatorit, mund të konsiderohet si i mjaftueshëm dhe i qartë, në mënyrë të përgjithshme.

Do të flasim së pari për Dërguesin, së dyti për të Dërguarin dhe së treti për Mesazhin.

I mbështetem Zotit, ndihmës së Tij dhe Atij i rikthehem!

Muhammed Bakir Sadër

**ZOTI, DËRGUESI I
MADHËRUAR DHE
I LAVDËRUAR**

BESIMI NË ZOTIN E MADHËRUAR

Njeriu ka besuar në Zot që nga kohët e lashta, e ka adhuruar, i është mbështetur dhe ka ndier lidhje të fortë me Të para se të mbërrijë ndonjë periudhë të mendimit teorik filozofik ose eventualisht para se t'i kuptojë metodat e argumentimit.

Ky besim nuk ka qenë prodhim i grindjes klasore, as i eksploatorëve tiranë për ta stabilizuar eksploatimin e tyre, e as i të eksploatuarve të shtypur si konsolacion sepse ky besim i ka paraprirë çdo lloji të tillë gjatë historisë njerëzore.

Ky besim nuk është formuar nga frika prej katastrofave natyrore, sepse sikur të ndodhte një gjë e tillë, njerëzit më fetarë do të ishin më tepër frikacakë dhe më zemërlëshuar në histori.

Përkundrazi, hasim se fetarët gjatë kohëve të kaluara gjithmonë kanë qenë më të fuqishëm dhe më të qëndrueshëm.

Pra, ky besim i njeriut paraqet anim instinktiv ndaj Krijuesit të tij dhe intuitë të ngulitur, me të cilën njeh relacionin e tij me ekzistencën e Zotit të tij.

Më vonë, njeriu ka filozofuar dhe ka rezultuar prej gjërave që e rrethojnë në gjithësi, koncepcione të përgjithshme, si: ekzistenca, hiçi, obligativiteti, e mundura, absurditeti, uniteti, shuma, përbërja, thjeshtëzimi, parcialja, universalja, a priori, a posteriori, shkaku, i shkaktuari, dhe më së shumti i ka përdorur dhe praktikuar në lëmin e argumentit, për ta konfirmuar dhe arsyetuar besimin origjinal në Zotin e Madhëruar e të Lartësuar, në bazë të filozofisë dhe metodave të hulumtimit filozofik.

Kur ka filluar empirizmi të paraqitet në hulumtimin shkencor si vegël e njohjes dhe kur mendimtarët kanë kuptuar se ato koncepcione të përgjithshme nuk mjaftojnë për zbulimin e rregullave të natyrës dhe sekreteve të gjithësisë, janë bindur se shqisa dhe observimi shkencor janë parimet themelore për hulumtimin e këtyre sekreteve dhe rregullave.

Kjo doktrinë sensuale vlerësohet shumë, eventualisht, në hulumtimin për progresivitetin e eksperiencës njerëzore dhe zgjerimin e saj mbi gjithësinë.

Në realitet, sipas kësaj doktrine, shqisa dhe eksperimenti, janë dy vegla të cilat intelekti dhe njohja njerëzore obligohen t'i praktikojnë për t'i zbuluar sekretet dhe sistemet e përpikta në gjithësi. Kështu, kishte nevojë të ulet ndonjë mendimtar grek, si Aristoteli, në dhomën e tij të mbyllur e të qetë e të mendojë për mënyrën e relacionit mes lëvizjes së trupit në gjithësi prej një vendi në vend tjetër dhe në mes fuqisë lëvizëse e të deklarojë se trupi ndalet menjëherë pas përfundimit të fuqisë lëvizëse. Por, në vend të këtij qëndrimi, Galileu i qaset eksperimentit, i observon trupat e lëvizshëm që të indukojnë një relacion që i përket një llojit tjetër:

“Nëse në trup ndikon ndonjë fuqi që e lëvizë atë, do të vazhdojë të lëvizë edhe nëse përfundon ajo fuqi, derisa të konfrontohet me ndonjë fuqi penguese.”

Kjo doktrinë sensuale i nxitë hulumtuesit e problemeve të natyrës dhe të fenomeneve kozmologjike, për të arritur një gjë të tillë sipas dy periudhave:

- 1. PERIUDHA E PARË:** Periudha e sensualitetit, empirizmit dhe sintetizimit të rezultateve.
- 2. PERIUDHA E DYTË:** Periudha racionale - periudha e induksionit dhe akordimit të rezultateve, për të përfituar një komentim të përgjithshëm pozitiv.

Sipas realitetit shkencor, sensualizmi dhe aplikimi i kësaj doktrine nga ana e dijetarëve, nuk paraqet mohimin e intelektit.

Nuk ka mundur asnjë fizikan të zbulojë ndonjë sekret kozmologjik ose rregull të natyrës në bazë të sensualitetit dhe empirizmit, por vetëm me intelekt.

Në periudhën e parë, i përmbledh observimet që e pasurojnë eksperiencën e tij, pastaj i balancon në periudhën e dytë me intelektin e tij, për ta përfituar rezultatin.

Nuk njohim asnjë sukses shkencor që e mohon periudhën e dytë dhe që nuk ka kaluar nëpër këto dy periudha. Problemet e periudhës së parë janë sensuale kurse të së dytës induktive e argumentuese dhe njihen me intelekt, si p.sh., Njutni në Ligjin e gravitetit nuk e ka vërejtur gravitimin mes dy trupave në mënyrë direkte, por e ka vërejtur trupin që ka rënë në tokë, hënën që rrotullohet rreth tokës, yjet që rrotullohen rreth diellit, e nuk ka vërejtur se është në përpjesëtim të zhdrejtë me katrorin e largësisë midis dy trupave dhe në përpjesëtim të drejtë me masën e secilit prej tyre (Ligji i grav. M.M.), dhe kështu ka filluar të kujtojë rreth tyre.

Ka vazhduar ta komentojë në mënyrë të përgjithshme shpejtësinë e sistemizuar, trupat që bien në tokë duke u mbështetur në teorinë e Galileut si dhe në teorinë e Keplerit që flet për lëvizjen e yjeve:

“Një e katërta e kohës së qarkullimit të çdo ylli rreth diellit është reciproke me masën e largësisë. Në bazë të kësaj, është zbuluar Ligji i gravitetit dhe është paramenduar fuqia gravituese në mes trupave. Fuqia është reciproke dhe varet nga masa e trupit si dhe nga shkalla e distancës”.

Sipas kësaj u zbulua graviteti.

Kjo doktrinë sensuale dhe empiriste, gjatë hulumtimit të sistemit të gjithësisë, ka mundur ta përforcojë besimin në Zotin e Madhëruar e të Lartësuar, në mënyrë të shkëlqyeshme, për shkak të zbulimit të harmonisë dhe shenjave të Urtësisë që konfirmojnë Krijuesin e Urtë.

Fizikanët, si hulumtues të natyrës, nuk janë interesuar për këtë problem që konsiderohet ende si filozofik, sipas kategorizimit bashkëkohor të problemeve të njohjes njerëzore.

Shumë shpejt, në suazat e lëmisë filozofike dhe jasht suazave shkencore, janë formuar doktrina filozofike dhe logjike që janë orvatur ta filozofojnë ose logjikojnë këtë drejtim sensualist:

“Vegla e vetme për njohje është shqisa dhe aty ku përfundon ajo, përfundon edhe njohja e njeriut. Çdo gjë që nuk është materiale dhe nuk mund të eksperimentohet, në një formë apo tjetër, njeriu nuk ka mjet për konfirmimin e saj.”

Për ta kritikuar idenë e besimit në Zotin e Madhëruar, është aplikuar kjo doktrinë sensuale dhe empiriste.

Përderisa Zoti nuk është gjë e dukshme dhe nuk shihet, atëherë nuk mund të konfirmohet në asnjëfarë mënyrë.

Këtë teori nuk e kanë aplikuar shkencëtarët empiristë por një grup filozofësh me prirje filozofike dhe logjike.

Eksplikimi filozofik dhe logjik i kësaj doktrine ka qenë i gabuar dhe gradualisht këto drejtime fanatike kanë rënë në kontradiktë e sipër.

Sipas aspektit filozofik, këto dy drejtime janë obliguar ta mohojnë realitetin objektiv ose ta mohojnë gjithësinë, ku jetojnë përgjithësisht dhe pjesërisht, ngase ne posedojmë vetëm shqisa; me shqisa i njohim gjërat ashtu siç i shikojmë dhe si i vërejmë e jo ashtu si janë. Kur vërejmë ndonjë gjë, konfirmojmë ekzistencën e saj në shqisat tona, kurse ekzistencën e saj jashtë memories sonë, në formë të posaçme objektive nuk mund ta konfirmojmë.

Kur e sheh hënën në qiell, mund të dëshmosh vetëm për vizionin tënd të hënës dhe ndjenjën tënde në atë çast.

Në pyetjet: “A është hëna me të vërtetë në qiell, a ekziston para se t’i hapish sytë e ta shikosh?”, ithtarët e këtyre drejtimeve e kanë gjetur veten të paaftë për një dëshmi ose konfirmim të plotë, si vangoshi që i sheh gjërat që nuk ekzistojnë dhe e konfirmon vizionin e tij, por jo edhe realitetin.

Kështu në fund, kjo doktrinë vet e ka destruktuar sensualitetin si mjet të njohjes dhe e ka konsideruar si shkallë të fundit.

E gjithë njohja sensuale, është shndërruar në fenomen që nuk ka formë të pavarur jashtë memories dhe perceptimit tonë.

Kurse sipas aspektit logjik, kjo doktrinë që është shndërruar në një rrymë moderne pozitiviste, thotë:

“Çdo fjali që nuk mund të konfirmohet ose gënjehet me shqisa dhe eksperiment, është e pakuptimtë.”

Çështja e saj i ngjan asaj të shkronjave të alfabetit të shpërndara në mënyrë kaotike, kurse fjalia e cila mund të konfirmohet ose të shtrembërohet, ka kuptim nëse sensualisht konfirmohet konkordanca mes kuptimit dhe realitetit. Nëse një gjë e tillë konfirmohet, quhet fjali e afirmuar e nëse jo, atëherë është e rrejshme.

Nëse thua se shiu bie nga qielli në dimër, atëherë kjo është fjali e dobishme dhe konfirmative e nëse thua se shiu bie në verë, atëherë edhe kjo ka kuptim por të rrejshëm.

Nëse thua se një gjë që nuk shihet e as nuk preket zbrit natën e Kadrit, nuk është e dobishme ngase nuk është as konfirmative e as e rrejshme. Nuk mund ta konfirmojmë vërtetësinë ose

gënjeshtrën e saj me shqisa dhe empirizëm. Në bazë të kësaj, nëse thua “Zoti ekziston”, do të ishte ngjashëm me përdorimin e termit të pakuptimtë. Edhe kjo fjali me atë të parën nuk kanë kuptim sepse ekzistenca e Zotit të Madhëruar nuk njihet me shqisë dhe empirizëm.

Edhe kjo doktrinë është kontradiktore sepse vet ajo që e tregon fjalja, nuk mund të njihet në mënyrë direkte dhe kështu pra, shndërrohet në fjali të pakuptimtë.

Kjo doktrinë e logjikës, e cila pohon se çdo fjali që nuk konfirmohet me shqisa dhe empirizëm konsiderohet e pakuptimtë, është përmbledhëse.

Çdo përmbledhje e tejkalon sferën e shqisave sepse shqisat i perceptojnë vetëm gjësendet parcialet dhe të përkufizuara.

Në fund, kjo doktrinë është në kundërti me vetveten bile edhe me të gjitha gjeneralizimet shkencore që i përdorin shkencëtarët për t’i eksplikuuar fenomenet e gjithësisë në mënyrë precize, ngase çdo gjeneralizim nuk mund të perceptohet në mënyrë të drejtpërdrejt por induktohet dhe argumentohet në bazë të kuptimit të fenomeneve sensuale dhe të përkufizuara.¹

Për fat të mirë, shkenca nuk është përqëndruar shumë në këto doktrina dhe gjithmonë e ka vazhduar misionin e zbulimit të gjithësisë duke u nisur nga shqisat dhe empirizmi. Pastaj, i ka tejkualuar definicionet e ngushta filozofike dhe logjike dhe racionalisht është orvatur t’i sistematizojë fenomenet, t’i lokalizojë brenda ligjeve gjenerale dhe t’i njohë lidhjet dhe relacionet mes tyre.

Veç është pakësuar ndikimi filozofik dhe logjik i këtyre doktrinave fanatike, refuzimin e tyre e gjejmë edhe në doktrinën filozofike materialiste.

Filozofia materialiste moderne, e kryesuar kryesisht nga materialistët dialektikë, i refuzon idetë e tyre në mënyrë të qartë dhe pranon të drejtën e tejkualimit të sferave shqisore dhe empiriste, me të cilat fillon shkencëtarin hulumtimet e tij, bile e tejkualon edhe periudhën e dytë me të cilën shkencëtarin e përfundon hulumtimin e tij, për të zhvilluar një komparacion mes rezultateve të ndryshme shkencore dhe për të formuluar një eksplikim teorik të përgjithshëm si dhe për t’i caktuar mënyrat e lidhjeve dhe relacioneve që mund të formohen.

Kështu, materializmi dialektik, i cili konsiderohet si trashëgimtar bashkëkohor i mendimit materialist në histori, është shndërruar në metafizikë - sipas mendimit të doktrinave sensualiste fanatike - kur e ka eksplikuuar përgjithësisht gjithësinë dialektike.

Kjo do të thotë se filozofia materialiste së bashku me atë idealiste, janë në pëlqim e sipër që të tejkualohet sfera shqisore e doktrinave materialiste fanatike.

Kështu, është logjike që njohja të përfitojë dy periudha:

1. Periudha e përmbledhjes së rezultateve të shqisave dhe empirizmit,

¹ Më gjerësisht, për logjikën pozitiviste shiko librin tim “Bazat e logjikës induktive.”

2. Periudha e eksplikimit të tyre në mënyrë teorike dhe racionale.

Dallimi mes materialistëve dhe idealistëve qëndron në mënyrën e eksplikimit racional të rezultateve të ndryshme shkencore në periudhën e dytë.

Materializmi mohon ekzistimin e Krijuesit të Urtë, kurse idealizmi pohon se një eksplikim i tillë nuk është bindës, gjersa nuk e pranon ekzistencën e Krijuesit të Urtë.

Në vijim do të cekim dy lloje argumentimi për ekzistimin e krijimit e Krijuesit të Urtë e të Lartmadhëruar, që përmbajnë në një anë rezultate sensuale dhe empiriste, kurse në anën tjetër sistematizimin e tyre në mënyrë racionale dhe konkluzionin se gjithësia është krijuar nga Krijuesi i Urtë.

Shembulli i parë quhet “argument shkencor” ose “argument induktiv”,

Shembulli i dytë quhet “argument filozofik”.

Do të fillojmë me argumentimin shkencor, por së pari të sqarojmë se ç’kemi për qëllim me “argumentim shkencor”:

- Argument shkencor është çdo argument që mbështetet në shqisa dhe empirizëm, ndjek metodën e argumentit induktiv dhe mbështetet në hipoteza.

Pra, metoda e këtij argumentimi për konfirmimin e Krijuesit të Madhëruar, është ajo e argumentit induktiv që mbështetet në hipoteza.²

Për këtë shkak, flasim mbi argumentin shkencor për konfirmimin e Krijuesit me argument induktiv. Sqarimi i gjithë kësaj vijon kështu:

² Metoda e argumentimit nuk është si vetë argumenti. Ti ndoshta argumenton se dielli është më i madh se hëna sepse shkencëtarët pohojnë ashtu, por këtu, si metodë është mbështetja në pohimet e shkencëtarëve për ta argumentuar të vërtetën.

Ndoshta argumenton se filani së shpejti do të vdes, duke u mbështetur në ëndrrën që e ke parë se ai ka vdekur. Pra, këtu mbështetesh në ëndërr, për ta argumentuar të vërtetën.

Pastaj, argumenton se bota ka dualitet të madh magnetik: polin pozitiv dhe polin negativ, duke u mbështetur në atë se gjilpëra megnetike horizontale gjithmonë anon me një anë kah veriu kurse me tjetrën kah jugu.

Këtu si metodë është argumenti i mbështetur në empirizëm.

Autenticiteti i mbarë këtij argumentimi, në esencë varet nga autenticiteti i metodës së aplikuar.

ARGUMENTIMI SHKENCOR MBI EKZISTIMIN E ZOTIT TË MADHËRUAR

Pamë se argumenti shkencor mbi ekzistimin e Krijuesit të Madhëruar mbështetet në metodën e argumentit induktiv, të formuar nga hipotezat.

Para se të fillojmë me këtë argument, dëshirojmë ta eksplikojmë këtë metodë dhe pastaj ta vlerësojmë, që të kuptojmë se sa mund të mbështetemi në këtë metodë, për t'i zbuluar të vërtetat dhe për t'i njohur gjërat.

Metoda e argumentit induktiv që mbështetet në hipoteza ka forma të ndërlikuara, është shumë më precize dhe vlerësimi i saj i plotë realizohet me anë të studimit analitik e perfekt të bazave të logjikës induktive dhe të teorisë së hipotezës.³

Këtu do të kemi kujdes për shkak të vështirësive, do të largohemi nga format e ndërlikuara dhe nga analiza që është vështirë të kuptohet.

Për këtë shkak, do të ndërmarrim dy gjëra:

1. Përkufizimin e metodës që do ta ndjekim gjatë argumentimit dhe qartësimin e hapave në mënyrë të thjeshtë dhe hyrëse.
2. Vlerësimin e kësaj metode, përcaktimin e mundësisë së mbështetjes në të duke mos u bazuar në logjikë dhe zbulimin e bazave logjike dhe aritmetike, sepse kjo na obligon të hymë në gjëra të ndërlikuara dhe në mendime shumë precize, por do ta vlerësojmë metodën e argumentimit që do ta përcjellim mbi Krijuesin e Urtë në bazë të disa analizave të gjera shkencore të cilat i njeh çdokush.

Bëjmë të qartë se metoda e argumentimit mbi ekzistimin e Zotit të Urtë, është ajo e njëjta që e kemi përcjellur gjatë argumentimeve tona të përditshme ose në hulumtimet shkencore empiriste.

Pjesa vijuese do të qartësohet mjaft duke u mbështetur në atë se metoda e argumentimit mbi ekzistimin e Zotit të Urtë është në realitet metodë që e përdorim zakonisht për konfirmimin e të vërtetave të jetës së përditshme dhe të vërtetave shkencore.

Nëse jemi të bindur në këto të vërteta, atëherë patjetër duhet të jemi të bindur edhe në konfirmimin e Krijuesit të Urtë, që është bazë e të gjitha të vërtetave.

³ Shiko më gjerësisht në librin: “Bazat e logjikës induktive”, kapitulli i tretë, f. 133 - 410.

Ti, në jetën normale, kur pranon letër me postë, vetëm në bazë të leximit konkludon se vjen nga vëllai yt.

Kur dëgjon se një mjek ka pasur sukses në shërimin e shumë sëmundjeve me plot bindje e pranon si mjek të shkathët.

Kur e pranon gjilpërën penicilin në dhjetë raste semurjesh, dhe i vëren të njëjtat simptome pas çdo përdorimi të tij, konkludon se ke trup alergjik, e posaçërisht ndaj penicilinit.

Ti në të gjitha këto argumente më realitet ke përdorur metodën e argumentit induktiv që mbështetet në hipoteza.

Fizikani gjatë hulumtimeve të tij shkencore, kur vëren karakteristika të posaçme në sistemin diellor, bindet se ato trupa janë të ndarë nga dielli.

Ai argumenton ekzistencën e Neptunit - pjesë e sistemit diellor - në bazë të precizitetit të lëvizjes së yjeve para se ta zbulosh atë me shqisa.

Pastaj sipas fenomeneve të posaçme argumenton ekzistimin e elektroneve para se të zbulohet mikroskopi i atomeve.

Fizikani në të gjitha këto raste, në realitet përdorë metodën e argumentit induktiv të mbështetur në hipoteza.

Pra, këtë metodë argumentuese e hasim në vijim, për ta konfirmuar Krijuesin e Urtë.

Këtë gjë do ta vërejmë në mënyrë të qartë gjatë analizës së këtij argumenti.

1. PËRKUFIZIMI I METODËS DHE ÇAKTIMI I PIKAVE TË SAJ

Metoda e argumentimit induktiv që mbështetet në hipoteza, mund të rezymohet - nëse dëshirojmë qartësi dhe thjeshtësi - me pesë pikat vijuese:

- *Një:* Përballohem në sferën e shqisave dhe eksperimentit me fenomene të ndryshme.
- *Dy:* Kalojmë pas observimit dhe sintetizimit të tyre në periudhën e eksplikimit. Në këtë periudhë jemi të obliguar të gjejmë një hipotezë solide për eksplikimin e këtyre fenomeneve. Këtu kemi për qëllim që, nëse është e vërtetë, thellohet, është proporcionale me ekzistencën e të gjitha fenomeneve që në realitet ekzistojnë.
- *Tre:* Vërejmë se nëse kjo hipotezë nuk është solide dhe e vërtetë, atëherë mundësia e ekzistencës së përbashkët të të gjitha fenomeneve do të ishte shumë e kufizuar.

Pra, nëse kjo hipotezë nuk është solide, atëherë relacioni i probabilitetit të ekzistencës së tyre me probabilitetin e hiçit ose më së paku, të mosekzistimit të njëres prej tyre, do të ishte shumë i kufizuar, si një me njëqind ose një me një mijë.

- *Katër:* Mund të konkludojmë se hipoteza është solide. Një soliditet i tillë mund të argumentohet në bazë të vërejtjes së fenomeneve në pikën e parë.

- *Pesë*: Analiza e relacionit të vlerës së probabilitetit,⁴ të konfirmimit me ekzistencën dhe mosekzistencën e fenomeneve.

Në realitet, për vlerën e probabilitetit ekzistojnë rregulla dhe parime të përpikta.

Njeriu gjatë jetës së përditshme i praktikon këto rregulla dhe parime në mënyrë instinktive në raste të përditshmërisë dhe për këtë shkak, këtu do të mbështetemi në vlerësimin instinktiv, pa kurrfarë përimtësimi të ndërlikuar.⁵

Këto pika zakonisht aplikohen në çdo argumentim induktiv që mbështetet në hipotezë, qoftë në jetën e përditshme, në hulumtimin shkencor apo në argumentimin e Krijuesit të Urtë e të Madhëruar.

2. VLERËSIMI I METODËS

Do ta vlerësojmë këtë metodë me shembuj dhe ushtrime, ashtu siç premtuam më parë.

Së pari do të fillojmë me shembuj nga jeta e përditshme.

Pak më parë cekëm se ti kur pranon një letër me postë, pas leximit, e njeh se është nga vëllai yt e jo nga ndonjë shkrues tjetër.

Në këtë mënyrë ti e aplikon argumentimin induktiv të mbështetur në hipotezë dhe sado që ajo të jetë çështje (letra nga vëllai yt) e qartë në mendimin tënd, prapëseprapë konkludimi është rezultat i argumentit induktiv, që zhvillohet sipas metodës së kaluar.

Në pikën e parë, ballafaqohesh me fenomene të ndryshme: në letër është emri që i ngjan atij të vëllait tënd dhe është shkruar sipas stilit të shkrimit të vëllait tënd, stili i ekspresivitetit është i njëjtë me atë të vëllait tënd, informatat janë sikur ato të vëllait tënd dhe në të (në letër) ka gjëra që e interesojnë vëllain tënd.

Të gjitha këto janë fenomene!

Në pikën e dytë pyet: A e ka dërguar me të vërtetë vëllai yt letrën apo ndonjë individ tjetër me emër të ngjashëm?

Këtu ke një hipotezë solide për eksplikimin e të gjitha fenomeneve. Para se të konstatosh se letra me të vërtetë është nga vëllai yt ekzistojnë të gjitha informatat që i vërejtëm në periudhën e parë.

Në pikën e tretë e pyet veten kështu: “Nëse letra nuk është nga vëllai yt por nga ndonjë individ tjetër, atëherë çfarë probabiliteti ekziston në paraqitjen e të gjitha karakteristikave që i vërejtëm në pikën e parë?”

⁴ Këtu nënkuptojmë mosekzistencën e tyre ose mosekzistencën e vetëm njëres prej tyre. Shiko më gjerësisht librin “Bazat e logjikës induktive”, f. 355-410

⁵ Shiko më gjerësisht “Bazat e logjikës induktive”, f. 146-247.

Ky probabilitet ka nevojë për një numër hipotezash, sepse për t'i arritur të gjitha informatat dhe karakteristikat, në këtë rast duhet të paramendojmë se ekziston një individ tjetër, me emër të njëjtë dhe që plotësisht i ngjan vëllait tënd, si në mënyrën e shkrimit të shkronjave, radhitjen e fjalëve, stilin e ekspresivitetit, ashtu edhe në nivelin e kulturës gjuhësore, hartuese...

Sipas kësaj, ky rast konsiderohet shumë i kufizuar dhe sa më tepër të shumohen këto raste, aq më tepër pakësohet probabiliteti.

Bazat e logjikës induktive na mësojnë se si ta lexojmë hipotezën, si zvogëlohet probabiliteti dhe pse.

Nuk ka nevojë për një përimtësim sepse kjo metodë është shumë e ndërlikuar dhe e pakuptueshme për lexuesin e rëndomtë.

Për fat të mirë, një gjë e tillë nuk varet nga përimtësimi sepse njohja e gravitacionit së bashku me formulën e tij shkencore nuk e pengon rrëzimin e njeriut prej lartë në tokë.

Nuk kemi nevojë për asnjë gjë që konfirmon se probabiliteti i ekzistimit të ndonjë individi tjetër të ngjashëm me vëllain tënd është shumë i largët.

Banka nuk ka nevojë t'i kuptojë bazat e logjikës induktive për ta kuptuar se probabiliteti i tërheqjes së të gjitha deponimeve përnjëherë është shumë i vogël, kurse një gjest i tillë nga një ose dy persona është më efektiv.

Në pikën e katërt thua: pasi që të gjitha këto dilema me letrën janë të pamundshme, pos një probabiliteti shumë të vogël, atëherë është më e pranuar që letra të jetë e vëllait tënd.

Në pikën e pestë, formon një relacion mes pranimit që gjendet në pikën e katërt (se letra është e vëllait tënd) dhe mes probabilitetit të vogël, që e pranove në pikën e tretë së nuk mund të jenë të gjitha këto karakteristika në një letër e cila nuk është nga vëllai yt. Lidhja mes këtyre dy pikave do të thotë: sa më i kufizuar të jetë probabiliteti, aq më i vlefshëm dhe aq më bindës do të jetë pranimi.

Nëse nuk ekzistojnë indikacione të kundërta që e mohojnë letrën e vëllait tënd, atëherë në bazë të këtyre pesë pikave do të përfitosh bindje të plotë se letra është nga vetë ai.

Ky shembull është marrë nga jeta e përditshme e çdo njeriu.

Të marrim një shembull tjetër, nga metoda e argumentimit teorik shkencor, si psh. teoria e formimit të yjeve qarkulluese:

“Nëntë planetët qarkullues janë formuar nga dielli kur janë ndarë si trupa të zjarrrë para miliona vjetësh”.

Përgjithësisht, shkencëtarët e kanë pranuar këtë teori por, në realitet i gjejmë të ndarë në mendimin e tyre mbi shkakun e ndarjes së tyre (planetëve) nga dielli.

Argumentimi i kësaj teorie zhvillohet sipas pikave vijuese.

PIKA E PARË

Shkencëtarët kanë vërejtur disa fenomene me anë të shqisave dhe përvojës shkencore të tyre:

1. Lëvizja e tokës rreth diellit është në përputhshmëri me lëvizjen e diellit rreth boshtit të vet dhe secila lëvizë nga Perëndimi në Lindje.
2. Qarkullimi i tokës rreth boshtit të vet është në përputhshmëri me rrotullimin e diellit rreth vetes, pra prej Perëndimit në Lindje.
3. Toka rrotullohet rreth diellit.
4. Elementet e tokës janë përafërsisht të ngjashme me ato të diellit.
5. Përqindja e elementeve është e ngjashme, psh. hidrogjeni është kryesori në të dyja.
6. Ekziston një harmoni mes shpejtësisë së qarkullimit të tokës rreth diellit dhe boshtit të vet si dhe mes shpejtësisë së qarkullimit të diellit rreth vetes.
7. Gjithashtu ka harmoni, mes jetës së tokës dhe diellit, sipas vendimeve shkencore.
8. Brendësia e tokës është e ngrohtë dhe kjo gjë argumenton se toka në fillim të krijimit ka qenë shumë e nxehtë.

Shkencëtarët i vërejnë këto fenomene në pikën e parë, me shqisa dhe eksperimente.

PIKA E DYTË

Shkencëtarët kanë vërejtur se ekziston hipoteza që mund t'i eksplikojë të gjitha këto fenomene të cilat gjenden në pikën e parë.

Pra, nëse janë të vërteta, i studion dhe i komenton:

“Toka ka qenë pjesë e diellit dhe ndonjë shkak e ka ndarë”. Pra, sipas këtij vendimi, na mundësohet t'i eksplikojmë esencialisht këto fenomene.”

FENOMENI I PARË

Lëvizja e tokës rreth diellit është në përputhshmëri me lëvizjen e diellit rreth boshtit të vet prej Perëndimit në Lindje.

Shkaku i kësaj përputhshmërie është i qartë për përcaktimin e soliditetit të kësaj hipoteze.

Çdo trup që ndahet nga një trup lëvizës, lëviz në drejtim të njëjtë me trupin lëvizës sipas ligjit të kontinuitetit.

FENOMENI I DYTË

Qarkullimi i tokës rreth vetes është në përputhshmëri me qarkullimin e diellit rreth vetes, nga Perëndimi në Lindje.

Hipoteza e përmendur gjithashtu mjafton për një eksplikim të tillë, sepse trupi i ndarë nga trupi që qarkullon prej Perëndimit në Lindje, e pranon të njëjtën lëvizje, sipas ligjit të kontinuitetit.

FENOMENI I TRETË

Gjithashtu, edhe fenomeni i tretë e pranon të njëjtën lëvizje si edhe i dyti.

FENOMENI I KATËRT DHE I PESTË

Përputhshmëria mes elementeve të tokës dhe të diellit është e qartë, sepse toka është pjesë e diellit.

Pra, elementet e parciales janë të ngjashme me elementet e universales.

FENOMENI I GJASHTË

Harmonizimi mes shpejtësisë së qarkullimit të tokës rreth diellit e rreth vetes dhe mes qarkullimit të diellit rreth vetes, na mundëson të kuptojmë se toka është e ndarë nga dielli, apo të dy lëvizjet e tokës janë formuar nga lëvizja e diellit.

Kështu eksplikohet harmonizimi i cekur dhe definohet shkaku.

FENOMENI I SHTATË

Harmonizimi mes jetës së tokës dhe diellit është i qartë sipas teorisë së separacionit.

FENOMENI I TETË

Gjithashtu, edhe këtu vërejmë se toka në fillim të formimit ka qenë shumë e nxehtë.

PIKA E TRETË

Nëse paramendohet që teoria e separacionit të tokës nga dielli nuk është e vërtetë, atëherë nuk mund të paramendohet se të gjitha këto fenomene grumbullohen rastësisht pa kurrfar relacioni.

Pra, probabiliteti i josaktësisë së kësaj teorie është shumë i kufizuar.

Për sa i përket përputhshmërisë së lëvizjes së tokës rreth diellit, me lëvizjen e diellit rreth vetes, prej Perëndimit në Lindje, patjetër të paramendojmë se toka ka qenë larg prej diellit, pa marrë parasysh se a është krijuar vetë ose ka qenë pjesë e një dielli tjetër, pastaj i është afruar diellit.

Gjithashtu paramendojmë se toka kur ka hyrë në sistemin diellor, ka hyrë në pikën e Perëndimit dhe kështu lëviz nga Perëndimi në Lindje, apo në drejtim të lëvizjes së diellit rreth

vetes, sepse sikur të hynte në qarkullimin diellor në një pikë të Lindjes, atëherë do të qarkullonte nga Lindja në Perëndim.

Sa i përket harmonizimit të elementeve të tokës me ato të diellit, patjetër të paramendojmë se toka ose dielli tjetër, prej të cilit është ndarë toka, kanë qenë të përbërë nga të njëjtat elemente.

Kurse, sa i përket harmonizimit mes shpejtësisë së qarkullimit të tokës rreth diellit dhe vetes dhe mes shpejtësisë së qarkullimit të diellit rreth vetes, mund të paramendojmë se dielli tjetër ka eksploduar dhe ia ka dhuruar tokës së ndarë shpejtësinë që është e njëjtë me lëvizjen e diellit tonë.

Për sa i përket jetës së tokës, diellit, nxehtësisë në fillim të krijimit të tokës, mund të paramendojmë se toka është ndarë nga një diell tjetër që ka jetë të ngjashme me diellin tonë.

Kështu, vërejmë se eksplikimi i këtyre fenomeneve sipas autenticitetit të teorisë së separacionit është i pranuar, kurse eksplikimi sipas teorisë së rastit është mjaft i kufizuar.

PIKA E KATËRT

Pasi që të gjitha këto fenomene që i vërejmë në tokë janë reale, atëherë mund të pajtohemi më tepër me idenë për ndarjen e tokës prej diellit, sepse në të kundërtën eksplikimi do të ishte shumë i kufizuar.

PIKA E PESTË

Përcaktojmë lidhshmëri mes pranimit të teorisë së ndarjes së tokës nga dielli, siç ndodhi në pikën e katërt, dhe mes kufizimit të teorisë së mosndarjes, siç u vërejt në pikën e tretë.

Kjo lidhshmëri mes dy pikave, do të thotë se sa më e fuqishme të jetë teoria e mosndarjes, aq më i madh do të jetë pranimi i teorisë së ndarjes në pikën e katërt.

Në këtë mënyrë argumentojmë teorinë e ndarjes së tokës dhe të diellit.

Gjithashtu edhe shkencëtarët, me këtë metodë kanë përfituar bindje të plotë.

SI E APLIKOJMË METODËN E ARGUMENTIMIT TË KRIJUESIT

Pasi u njoftuam me metodën gjenerale të argumentimit induktiv që mbështetet në hipoteza dhe pasi e vlerësuam këtë metodë me shembujt e cekur më parë, tani këtë metodë do ta aplikojmë për të argumentuar konfirmimin e Krijuesit të Urtë, duke u mbështetur në pikat e mëparshme.

PIKA E PARË

Këtu vërejmë harmonizim konstant, mes një numri të madh të fenomeneve të sistematizuara dhe mes nevojave të njeriut si qenie e gjallë si dhe lehtësimit të jetës së tij.

Gjithashtu vërejmë se çdo ndryshim i ndonjë fenomeni do të thotë shuarje e jetës së njeriut ose e mbarë ekzistencave në tokë.

Në vijim do të cekim disa fenomene si shembuj:

Toka nga dielli pranon një sasi të mjaftueshme të ngrohtësisë, sa për formimin e jetës dhe për plotësimin e nevojave të gjallesave, as më pak e as më shumë.

Shkencëtarisht është konstatuar se distanca mes tokës dhe diellit është proporcionale me sasinë e ngrohtësisë së nevojshme për jetë në tokë.

Sikur të ishte më e madhe ngrohtësia, nuk do të siguronte jetë dhe sikur të ishte vetëm gjysma, do të rritej ngrohtësia aq tepër saqë nuk do ta duronte jeta.

Shohim se sipërfaqja e tokës dhe oqeanet përmbajnë - në formë të komponenteve - sasi më të madhe oksigjeni, sa tetë të dhjetat nga krejt ujërat e botës.

Por një sasi e madhe e oksigjenit është e lirë për të formuar ajrin. Kjo sasi është kusht i obliguar për jetë sepse gjallesat - njeriu dhe kafshët - kanë nevojë të oksigjenit për frymëmarrje, sepse në të kundërtën, jeta nuk do të ekzistonte.

Përqindja e oksigjenit të lirë është proporcionale me nevojat e njeriut dhe me lehtësimin e jetës së tij praktike. Ajri përmban 21% të oksigjenit dhe sikur të ishte përqindja më e madhe, ambienti do të rrezikohej nga zjarret e përhershme, e sikur të ishte më e vogël jeta do të vështirësohej dhe zjarri nuk do të mjaftonte për nevojat personale.

Observojmë një fenomen natyror që vazhdimisht përsëritet miliona herë dhe që mbron një sasi të duhur të oksigjenit.

Pra, ky fenomen është njeriu.

Njeriu së bashku me të gjitha kafshët tjera, kur marrin frymë thithin oksigjenin që depërton në gjak e që shpërndahet në tërë trupin, pastaj formohet dioksid karboni që depërton në të dy mushkëritë dhe e nxjerrin jashtë.

Kështu, njeriu dhe kafshët e prodhojnë vazhdimisht këtë gaz. Vetë gazi është kusht i nevojshëm për bimët, kurse bimët pastaj lëshojnë oksigjen të pastër dhe të volitshëm për thithje.

Ky reciprocitet mes kafshëve dhe bimëve, mundëson mbrojtjen e një sasi të oksigjenit, e sikur të mos ishte kjo, do të vështirësohej ky element dhe definitivisht do të përfundonte jeta.

Ky reciprocitet është rezultat i mijëra fenomeneve natyrore që e prodhojnë këtë fenomen të nevojshëm për jetë.

Vërejmë se hidrogjeni është gaz i rëndë dhe se sasia e tij në gjithësi së bashku me oksigjenin është simetrike, ngase sasia e dytë e pakëson sasinë e parë dhe sikur të tepronte oksigjeni ose të pakësohej hidrogjeni, nuk do të ndodhte procesi i zvogëlimit.

Gjithashtu vërejmë se ajri përbën një sasi të caktuar në tokë, dhe pikërisht kjo sasi e lehtëson jetën e njeriut. Sikur të teprohej ose të pakësohej, askush nuk do të ekzistonte i gjallë. Përbërja e tepërt e ajrit shkakton zmadhimin e presionit të ajrit mbi njeriun aq sa nuk mund të durojë kurse pakësimi i tij, shkakton katastrofë në tokë.

Sikur sipërfaqja e tokës të thithte dioksid karbonin dhe oksigjenin në sasi më të madhe, do të ishte më e trashë kurse bimët, kafshët dhe njeriu do të shkatërroheshin.

Hëna, e cila është e larguar nga toka në një distancë të kufizuar, është në përputhshmëri me lehtësimin e jetës praktike të njeriut në tokë dhe sikur të ishte pak më larg do të zmadhoheshin batica dhe zbatica aq shumë sa që edhe kodrat do të lëviznin.

Ekzistojnë shumë instinkte në gjallesa.

Edhe pse instinktët konsiderohen si çështje metafizike dhe nuk shihen me shqisa në mënyrë direkte, ato prezantojnë një fenomen që mund të observohet në mënyrë shkencore.

Ky biheviore instinktiv si dhe mijëra instinkte tjera që i njeh njeriu gjatë jetës së tij të përditshme ose gjatë hulumtimeve shkencore, është në proporcionalitet me lehtësimin dhe mbrojtjen e jetës.

Instinkti ndonjëherë është çështje shumë e ndërlikuar. Nëse e përimitësojmë, vërejmë se çdo pjesë është determinuar për lehtësimin dhe mbrojtjen e jetës.

Përbërja fiziologjike e njeriut reprezenton miliona fenomene natyrore dhe fiziologjike.

Çdo fenomen me formën, rolin e tij fiziologjik dhe me korelacionin e tij me fenomenet tjera, vazhdimisht është në përputhshmëri me lehtësimin dhe mbrojtjen e jetës.

T'i marrim si shembuj disa fenomene të shikimit që e furnizon njeriun me fotografi të qarta.

Brishtëza e syrit i pranon format në mënyrë të rrjetës që formohet prej nëntë shtresave. Çdo shtresë kryen detyrën e vet për ta realizuar aftësinë e të pamurit dhe secila prej tyre është në lidhje të ngushtë me tjetrën. Çdo funksion i tyre e lehtëson jetën.

Bile edhe bukuritë dhe erërat e këndshme në natyrë e lehtësojnë jetën.

Lulet që polenizohen nga insektet, janë të bukura dhe atraktive kurse të tjerat nuk karakterizohen me ndonjë bukuri të posaçme.

Ka harmonizim të plotë mes përbërjes fiziologjike të femrës dhe të mashkullit për të siguruar reciprocitet dhe kontinuitet jetësor:

“Po edhe nëse përpiqeni t’i numëroni të mirat e All-llahut, nuk do të mund të arrini t’i përcaktoni ato.” (En-Nahlu, 18).

PIKA E DYTË

Ky harmonizim kontinuuiv në mes fenomenit natyror dhe sigurimit e lehtësimit të jetës në miliona raste, mund të eskplikohet vetëm në një mënyrë: Të paramendojmë Krijues të Urtë të kësaj gjithësie, i cili ka patur për qëllim sigurimin e elementeve të jetës.

Kjo mënyrë i eksplikon të gjitha këto harmoni.

PIKA E TRETË

Eventualisht nëse ideja e Krijuesit të Urtë nuk është reale, atëherë a do të mund të paramendoheshin të gjitha këto harmoni mes fenomeneve natyrore dhe lehtësimit të jetës pa ndonjë qëllim të caktuar?

Padyshim se një gjë e tillë nuk do të na shtyej ta pranojmë idenë e rastit, siç ndodhi me shembullin e letrës së dërguar me postë.

Teoria e ngjashmërisë mes letrës së vëllait tënd me ndonjë tjetër që i ka karakteristikat e ngjashme, është supozim jo i vërtetë.

Atëherë, si mund të paramendosh se tokën në të cilën jetojmë së bashku, me të gjitha komponentet e saja, e ka krijuar materia e paqëllim të dhe si mund t’i ngjajë Krijuesit të Urtë në miliona e miliona attribute?!

PIKA E KATËRT

Pranojmë pa kurrfarë dyshimi se hipoteza e pikës së dytë është e vërtetë apo se ekziston Krijues i Urtë.

PIKA E PESTË

Formojmë një lidhshmëri mes preferuesit dhe supozimit të paramenduar në pikën e tretë:

Pasi shtohet kufizimi i supozimit në pikën e tretë, varësisht nga shtimi i numrit të rasteve, do t’ishte gjë e natyrshme që kjo hipotezë e pikës së tretë të mos krahasohet me asnjë argumentim shkencor dhe të jetë shumë e kufizuar për shkak se numri i rasteve të paramenduara në probabilitetin e pikës së tretë është më i madh se në çdo rast tjetër të ngjashëm me të.

Çdo probabilitet i tillë zakonisht zhduket. Ngelin dy probleme që jemi të obliguar t'i analizojmë:

Problemi i parë: Sipas një hipoteze të metodës së argumentimit induktiv, mund të supozohet se çdo fenomen natyror që harmonizohet me lehtësimin e jetës, është produkt i domosdoshmërisë së materies së verbër për shkak të grindjeve interiore.

Qëllimi i argumentimit induktiv është vetëm preferim i hipotezës së Krijuesit të Urtë sepse del në shesh vetëm qenia e Urtë. Kurse hipoteza e domosdoshmërisë së materies së verbër, sjell me vete një numër të madh rastesh.

Teoria e rastit pra, në fund është autodestruktive.

Gjatë eksplikimit të të gjitha fenomeneve kozmologjike obligohemi të paramendojmë se Krijuesi i Urtë posedon njohuri dhe aftësi.

A mundet një materie e verbër t'i posedojë të gjitha këto karakteristika?

Cila prej tyre preferohet?

Këto domosdoshmëri të verbëta nuk janë të lidhura njëra me tjetrën, pra, janë indiferente kurse ngjarjet të pavarura së bashku me supozimet.

Njohuritë e aftësitë e Krijuesit të Urtë nuk janë të pavarura sepse çdo fenomen kërkon dituri dhe fuqi.

Pra, të gjitha këto probabilitete janë të kushtëzuara.

Problemi i dytë: Ky problem përfaqëson probabilitetin aprior të çështjes.

- Shpejtësia e bindjes së njeriut se letra është nga vëllai i tij, varet nga probabiliteti i kësaj çështje para se ta hapë letrën.

Nëse para hapjes së letrës paramendohet pesëdhjetë për qind, atëherë duke u mbështetur në pesë pikat e përmendura, do të formohet bindja se ajo është nga vëllai i tij.

Mirëpo, nëse vëllai ka vdekur, atëherë nuk do të ndërmarrë një qëndrim të tillë me shpejtësi, por do të mbështetet në indikacione të vërteta.

Atëherë, si mund të konfirmohet Krijuesi sipas kësaj metode?

Është e vërtetë se çështja e Krijuesit të Urtë nuk është probabilitative sepse një gjë e tillë argumentohet me instinkt.

Por, nëse supozojmë se është çështje probabilitative dhe duam ta konfirmojmë me argument induktiv, atëherë mund ta vlerësojmë kështu:

Çdo fenomen e studiojmë në mënyrë të pavarur dhe gjejmë se ekzistojnë dy supozime: ose të pranojmë Krijuesin e Urtë ose domosdoshmërinë e materies së verbër. Nëse nuk kemi asnjë argument për të anuar kah njëra prej të dyjave, atëherë e ndajmë bindjen në dy pjesë të barabarta dhe çdonjëra prej tyre prezenton pesëdhjetë për qind.

Pasi që probabilitetet e Krijuesit të Urtë janë të lidhura mes veti dhe të kushtëzuara, kurse ato të domosdoshmërisë së materies së verbër janë të pavarura dhe jo të kushtëzuara, atëherë

probabilitetet e Krijuesit të Urtë janë në rritje e sipër, kurse të së dytës në zvogëlim e kufizim...

- Gjatë studimit të vazhdueshëm, kam vërejtur se faktori që ka shkaktuar mospranimin dhe mohimin e argumentimit induktiv shkencor tek evropianët, si Ruseli, ka qenë se ata mendimtarë nuk kanë patur fuqi të dominojnë mbi këto dy probleme.

Më gjerësisht për mënyrën e aplikimit të metodave të argumentit induktiv dhe për konfirmimin e Krijuesit të Urtë, shiko librin: “Bazat e logjikës induktive”, faqe: 441-451.

Dhe kështu, arrijmë në një rezultat kategorik se gjithësinë e ka krijuar Krijuesi i Urtë:

“Ne do t’u bëjmë atyre të mundshme që t’i shohin argumentet tona në horizonte dhe në veten e tyre derisa t’u bëhet e qartë se ai (Kur’ani) është i vërtetë. A nuk mjafton që Zoti yt është dëshmitar për çdo gjë?!” (Fus-silet, 53)

“Është fakt se në krijimin e qiejve e të tokës, në ndërrimin e natës e të ditës, të anijes që lundron në det e që u sjell dobi njerëzve, në atë shi që e lëshon All-llahu prej së larti, e me të ngjall tokën pas vdekjes së saj dhe përhapë në te nga çdolloj gjallese, në qarkullimin e erërave dhe reve të nënshtruara mes qiellit e tokës, (në të gjitha këto), për një popull që ka mend ka argumente.” (El Bekare, 164)

“Drejto shikimin se a sheh ndonjë çarje? Mandej, herë pas herë, drejto shikimin, e shikimi do të kthehet te ti i përulur dhe i molisur.” (El-Mulk, 4-5)

ARGUMENTI FILOZOFIK

Para se ta fillojmë bisedën për argumentin filozofik të konfirmimit të Krijuesit të Madhëruar, vlen të pyesim se ç'është argumenti filozofik, çfarë është dallimi në mes tij dhe argumentit shkencor si dhe cilat janë llojet e këtij argumenti?

Ky argument ndahet në tri lloje: argumenti matematikor, shkencor dhe filozofik.

Argumenti matematikor aplikohet vetëm në lëmin e matematikës dhe në logjikën formale dhe gjithmonë mbështetet në parimin e antikundërshtimit:

(A) është (A) dhe nuk mund të jetë gjë tjetër pos (A-së).

Çdo argumenti dhe rezultati të tillë mund t'i themi se është matematikor.

Këtë argument e pranojnë të gjithë.

Argumenti shkencor aplikohet në shkencat natyrore dhe mbështetet në çështjet që konfirmohen me shqisa ose me induksion shkencor si dhe parimet e argumentit matematikor.

Argumenti filozofik, për ta konfirmuar realitetin objektiv të botës eksteriore, mbështetet në informatat racionale (informatat racionale nuk kanë nevojë për shqisa ose empirizëm) dhe në parimet e argumentit matematikor.

Kjo nuk do të thotë se në rast nevojë, argumenti filozofik nuk mbështetet në informatat sensuale ose në ato induktive, por nuk mjafton vetëm një mbështetje e tillë dhe për këtë shkak, mbështetet pavarësisht në informatat tjera racionale gjatë argumentit të çështjes që do ta konfirmojë.

Pra, argumenti filozofik ndryshon nga ai shkencor për shkak të marrëdhënieve të tij me informatat racionale që nuk hyjnë brenda suazave të argumentit matematikor.

Sipas kësaj që u tha, mund të pyesim kështu:

A mund të mbështetemi në informatat racionale apo në idetë që na i inspiron intelekti pa ndihmën e shqisave, empirizmit ose induksionit shkencor?

Përgjigjja është pozitive sepse ekzistojnë informata të pranuar në mënyrë të përgjithshme ashtu sikur të ishin të vërteta matematikore. Një bindje e tillë, gjatë induksionit mbështetet në parimin racional e jo në atë sensual, empirist.

Si shembull të marrim një ushtrim të qartë matematikor: $2+2=4$. Në këtë ushtrim jemi plotësisht të bindur, nuk pranojmë asgjë të kundërt si dhe nuk do të pranojmë nëse thuhet se dy edhe dy bëjnë pesë ose tre.

Kjo do të thotë se bindja jonë në këtë të vërtetë nuk varet nga shqisat ose empirizmi, sepse në të kundërtën do të ishte nën ndikimin pozitiv ose negativ.

Nëse jemi plotësisht të bindur në këtë të vërtetë, edhe pse nuk varet nga shqisat ose empirizmi, atëherë, natyrisht, ndonjëherë do të bindemi edhe me informatat racionale të cilat mbështeten në argumentin filozofik.

Me fjalë të tjera, refuzimi i argumentit filozofik për shkak të mbështetjes së tij në informata racionale, josensuale e as induktive, do të thotë gjithashtu edhe refuzim i argumentit matematikor ngase fillon prej parimit antikundërshtues.⁶

⁶ Më gjerësisht rreth logjikës empiriste dhe asaj pozitiviste, shiko: “Bazat e logjikës induktive”, f. 480-500

SHEMBULL NGA ARGUMENTI FILOZOFIK PËR KONFIRMIMIN E KRIJUESIT

Ky argument mbështetet në tri çështjet vijuese:

1. Aksiomën që thotë se çdo krijesë ka krijues që shkakton ekzistencën e saj.

Këtë çështje njeriu e njeh instinktivisht, kurse induksioni shkencor vazhdimisht e konfirmon një gjë të tillë.

2. Çështjen në të cilën thuhet se çdo ekzistim i shkallëzimeve diferenciale si psh: kjo gjë është më e fuqishme dhe më perfekte se gjërat tjera, nuk mund të paramendohet se gjëja që është më pak perfekte është shkak i ekzistencës me nivel më të lartë.

Ngrohtësia, njohja dhe drita, janë të shkallëzuara, disa janë më perfekte se të tjerat.

Shkalla më e lartë e zjarrit nuk mund të del nga ajo më e ulëta; njeriu nuk mund të përfitojë dituri të plotë në gjuhën angleze nga ndonjë person që e njeh fare ose aspak anglishten; zjarri i vogël nuk mund të japë më tepër dritë ngase çdo shkallëzim më i lartë prezenton ndryshim cilësor dhe sasior.

Këtë ndryshim nuk mund ta prodhojë ai që nuk e ka, psh. Ti, nëse dëshiron të financosh një projekt, nuk mund të ofrosh më tepër se ajo shumë që ekziston në bankë.

3. Materia, gjatë evolucionit të saj kontinuuiv merr forma të ndryshme. Një pikë e ujit që nuk ka jetë, paraqet një formë të ekzistencës së ujit.

Protoplazma paraqet një formë më të lartë të ekzistencës së materies.

Ameba mikroskopike njëqelizore, prezenton një shkallë të zhvilluar të materies.

Njeriu i gjallë, që ndien dhe mendon, prezenton formën më të lartë të ekzistencës në këtë gjithësi.

Nga këto forma të ndryshme të ekzistencës, vetvetiu shtrohet pyetja:

- A është kjo diferencë mes këtyre formave vetëm sasimore në pjesë, elemente dhe marrëdhënie mekanike, apo është edhe cilësore dhe prezenton shkallë të ndryshme apo periudha evolutive në ekzistencë?

Me fjalë të tjera, a është diferenca mes dheut dhe njeriut vetëm numerike apo është diferencë mes dy shkallëve të ekzistencës dhe dy periudhave evolutive, ashtu siç është diferenca mes dritës së dobët dhe asaj të fortë?

Njeriu, që nga kohët e lashta, instinktivisht ia ka shtruar vetes këtë pyetje.

Këto forma prezantojnë shkallë të ekzistencës dhe periudha evolutive.

Jeta është në një shkallë më të lartë se ekzistenca e materies. Edhe kjo shkallë është gjithashtu e shkallëzuar. Sa më tepër të fitojë vlerë jeta, aq më tepër prezanton një shkallë më të lartë dhe për këtë shkak, gjallesa që ndien dhe mendon, është në një shkallë më të pasur dhe më të lartë se jeta e bimëve.

Por, ideja materialiste, para më se një shekull e ka kundërshtuar këtë qëndrim, duke u mbështetur në eksperimentin mekanik të gjithësisë:

Sipas kësaj teorie, bota eksteriore përbëhet nga pjesëzat e imëta që janë nën ndikimin e fuqive të thjeshta, të ngjashme, centrifugale, centripetale brenda rregullave të përgjithshme, me fjalë të tjera, ndikimi lëvizës i tyre prej një vendi në një tjetër së bashku me fuqinë centrifugale dhe centripetale i bashkojnë pjesëzat, i shpërndajnë dhe i formojnë format e ndryshme të materies.

Në bazë të këtij parimi, materializmi mekanik e ka analizuar evolucionin dhe lëvizjen, i ka eksplikuuar format e ndryshme të materies pa kurëfarë ndryshimi të ri në materie.

Pra, materia as nuk zhvillohet e as nuk evoluon, por grumbullohet dhe shpërndahet në forma të ndryshme ashtu siç formon ti brum me forma të ndryshme. Brumi gjithmonë ngel i njëjtë pa kurrëfarë ndryshimi.

Kjo ide mekanike ishte e para në fushën e hulumtimeve të lira në shkencat natyrore dhe është favorizuar shumë për shkak të zbulimit të rregullave të lëvizjes mekanike dhe eksplikimit të lëvizjes së trupave të rëndomtë e të yjeve në gjithësi.

Por, kontinuiteti i progresit shkencor dhe zhvillimi i metodave të hulumtimit shkencor në lëmenj të tjerë të ndryshëm, veç e kanë konfirmuar falsitetin e kësaj teorie, paaftësinë e eksplikimit mekanik të të gjitha lëvizjeve në një anë dhe pamundësinë e grumbullimit të të gjitha formave të materies brenda lëvizjes mekanike të trupave dhe të trupthave prej një vendi në një vend tjetër, në anën tjetër.

Shkenca e ka konfirmuar atë që e ka perceptuar njeriu me instinktin e tij, që do të thotë se llojlojshmëria e formave të materies nuk varet nga transferimi prej një vendi në një vend tjetër por nga evolucionin cilësor.

Në bazë të eksperimenteve shkencore, është konstatuar se përbërja numerike e trupave nuk prezanton jetë, ndjenjë apo mendim.

Kjo ide krejtësisht ndryshon nga ajo e materializmit dialektik sepse në jetë vërejmë ndjenjë dhe mendim, një proces evolutiv të vërtetë në materie dhe një zhvillim cilësor të shkallëzuar, pa marrë parasysh se ky evolucion cilësor përmban në vete ndonjë gjë materiale apo jomateriale.

Këto ishin tri çështjet e cekura:

1. Për çdo ngjarje ka shkak,
2. Shkalla më e ulët nuk është shkak i asaj më të lartës, dhe
3. Diferenca e shkallëve të ekzistencës në këtë gjithësi dhe llojllojshmëria cilësore e formave të ekzistencës.

Në bazë të këtyre tri çështjeve, observojmë evolucion të vërtetë në llojet e cilësisë progresive, apo plotësim ekzistencial dhe cilësor në materie.

E drejtë e jona është të pyesim se prej nga erdhi ky plotësim?

Si u duk ky plotësim i ri, pasi që ne mendojmë se çdo ngjarjes i paraprinë shkak?

Këtu kemi dy përgjigje:

Përgjigjja e parë: Ky plotësim ka ardhur nga vet materia që nuk ka jetë, ndjenja dhe mend. Jetën, ndjenjat dhe mendjen i ka krijuar gjatë zhvillimit të saj, me fjalë të tjera, forma më e ulët e materies ka shkaktuar formën më të lartë dhe më të pasur.

Mirëpo, kjo përgjigje konfrontohet me çështjen e dytë të cekur më parë, ku thuhet se shkalla e formës më të ulët nuk mund të jetë shkak i asaj më të lartës dhe më të pasurës.

Hipoteza se materia e vdekur dhe e pajetë ia dhuron vetes ose ndonjë materies tjetër jetën, shqisën dhe mendjen, i ngjanë njeriut që jep mësim në gjuhën angleze ndërsa nuk e njeh atë gjuhë, dritës së zbehtë që mund të ndriçojë sa dielli, apo të varfërit që financon projekte kapitaliste.

Përgjigjja e dytë: Ky plotësim vjen nga një burim që karakterizohet me jetë, shqisë dhe mend, e që është Zoti i gjithë botëve.

Zhvillimin e materies e shkakton Zoti me urtinë, planifikimin dhe hyjninë e Tij:

“Për All-llahun, ne krijuam njeriun prej një ajke (lëngu) e një balte. Pastaj atë (ajkë-baltë) e bëmë (e shndërruam) pikë uji (fare) në një vend të sigurt. Më pas, atë pikë uji e bëmë copë gjaku, e atë gjak të ngurtë e bëmë copë mishi, e atë copë mishi e shndërruam në eshtra dhe eshtrave ua veshëm mishin, pastaj atë e bëmë krijesë tjetër (me shpirt)... I lartë është All-llahu, më i miri Krijues!” (El Mu’ëminunë, 12-14).

Vetëm kjo përgjigje përputhet me tri çështjet e cekura më parë dhe i jep eksplikim logjik procesit të evolucionit dhe plotësimit të formave të ekzistencës në këtë gjithësi të gjerë.

Në shumë ajete të Kur’anit, Zoti, kur i drejtohet instinktit të pastër dhe intelektit preciz të njeriut, flet për këtë argument:

“A më tregoni për farën që e derdhni: A ju e krijuat atë apo Ne jemi që e krijojmë?” (El Vakia, 58-59).

“A nuk e shihni atë që e mbillni? A ju e bëni të mbijë ajo apo Ne e bëjmë të mbijë?” (El Vakia, 63-64).

“A e keni parë zjarrin që ju e ndizni? A ju e krijuat drurin e tij, apo Ne jemi Krijues?” (El Vakia, 71-72).

“Nga faktet (e fuqisë) e Tij është edhe ajo se Ai ju krijoi prej dheu, e mandej ju (u zhvilluat) në njerëz që veproni të shpërndarë.” (Er Rum, 20).

QËNDRIMI I MATERIALIZMIT NDAJ KËTIJ ARGUMENTIMI

Tani do të cekim qëndrimin e materializmit ndaj këtij argumentimi:

Materializmi mekanik siç u pa, është i paaftë t'i përballojë këtij argumenti sepse i eksplikon: jetën, shqisat dhe mendjen, vetëm si forma të grumbullimit dhe shpërndarjes së trupave dhe substancave. Nuk ndodhë asgjë e re pos lëvizjes së pjesëzave sipas fuqive mekanike.

Materializmi modern, i cili mbështetet në evolucionin cilësor të këtyre formave, gjithashtu e gjen veten të paaftë para këtij argumenti.

Vetëm kjo teori, e harmonizon çështjen e përmendur më parë vetëm me materien, për t'i eksplikuuar të gjitha evolucionet.

Sipas kësaj metode, materia pra është dhënëse, e ndihmon procesin e evolucionit cilësor, por jo si financimi i të varfërit në projektet kapitaliste, që të kundërshtohet me çështjen e dytë të lartpërmendur.

Të gjitha format dhe komponentet e evolucionit kanë ekzistuar në materie që nga fillimi, pula ekziston në ve, gazi në ujë e kështu me radhë.

Pyetemi se si mund të jetë materia në të njëjtën kohë ve e pulë ose ujë dhe gaz? Materializmi dialektik e eksplikon këtë proces sipas parimit të grindjes, ngase ky parim e përmbledh tërë natyrën.

Çdo gjë që përmban në vete të kundërtën, qëndron gjithmonë në grindje kontinuitive me të. Si rezultat i kësaj grindjeje zhvillohet grindja interne gjersa të shkaktojë ndryshime në materie, siç ndodh me vezën që pëlcet në kohë të caktuar dhe nxjerr zogun nga brendësia.

Kështu, materia përkryhet vazhdimisht sepse grindja e brendshme prezenton ardhmërinë apo një hap në progres.

Këtu i vërejmë këto gjëra:

Çka ka për qëllim saktësisht materializmi modern me grindjen interne?

1. A mendon se veza dhe zogu janë në kundërshtim, veza e krijon zogun, ia dhuron jetën, i vdekuri e lind të gjallin dhe e krijon jetën?

Kjo i ngjan të varfërit që i financon projektet kapitaliste dhe që është në kundërti me aksiomën e cekur më parë.

2. Ose, mendon se veza nuk e krijon zogun por e nxjerr, pasi që ka qenë i fshehur në brendësi?

Veza, në të njëjtën kohë ka qenë edhe zog. Kjo i ngjan fotografisë që në një anë ka një formë kurse në anën tjetër, një formë tjetër.

Është e qartë se nëse veza është në të njëjtën kohë edhe zog, atëherë nuk ka kurrfarë procesi evolutiv apo të përkryer kur veza shndërrohet në pulë, sepse çdo gjë që ekziston tash, ka ekzistuar prej fillimit, ashtu siç ndodh me personin që i nxjerr të hollat nga xhepi e nuk shndërrohet në njeri më të pasur ngase ato të holla që janë në dorën e tij kanë qenë në xhep.

Për të ndodhur proces evolutiv, përkryes dhe për të ngjarë diçka e re gjatë shndërrimit të vesë në pulë, patjetër duhet të themi se veza nuk ka qenë as pulë e as zog por projektformuese e pulës apo një “diçka” që është në favor të krijimit të pulës.

Kjo dallohet nga guri ngase një gurë nuk mund të shndërrohet në pulë kurse veza po, në kushte dhe raste të volitshme.

Për një proces të tillë nuk mjafton vetëm parimi i probabilitetit.

Në anën tjetër, nëse format e materies janë formuar nga grindjet interiore, atëherë duhet të komentohet një llojllojshmëri e tillë sipas llojllojshmërisë interiore. Veza ka kundërshtime specifike që dallohen nga ato të ujit dhe kështu përfundojmë te veza në pulë dhe te gazi në ujë.

Kjo është e lehtë nëse e shikojmë periudhën e fundit të llojllojshmërisë së formave të materies, nëse shikohen nga aspekti i pjesëzave themelore në gjithësi, protoneve, neutroneve, elektroneve, fotoneve...

A e ka përfituar çdo trup formën e tij të posaçme në bazë të kundërshtive interiore?

Pra, protoni ka qenë në materien e tij dhe është paraqitur gjatë lëvizjes dhe grindjes, ashtu siç ndodh me pulën dhe venë!

Nëse paramendojmë një gjë të tillë, atëherë si e arsyetojmë llojllojshmërinë e formave të trupave që janë të ndryshëm dhe të llojllojshëm në ekzistencën e tyre të brendshme, përderisa e dimë se shkenca moderne e pranon unitetin e qenies së materies, e cila përmban në vete komponim të njëjtë?

Mund të shndërrohet protoni në neutron dhe mund të ndodh e kundërta, apo të ndryshojë forma e substancave...

Kjo do të thotë se komponimi është një edhe pse formohet llojllojshmëria e formave.

Pra, si mund të paramendojmë se këto forma janë krijuar nga kundërshtitë e ndryshme në brendësi?

Shembulli i vesë dhe i pulës është adekuat për sqarimin e këtij qëndrimi sepse për t'u formuar llojllojshmëria e formave që e marrin vezët për shkak të kundërshtive interiore, patjetër të jenë të ndryshme në komponimin interior. Veja e pulës dhe ajo e zogut fluturoes formojnë dy produkte në forma të ndryshme: pulën dhe zogun.

Sikur të ishin të dy vezët prej një lloji, si psh: dy vezë të pulës, nuk do të mund të paramendonim se kundërshtitë interiore do të shkaktojnë dy produkte të ndryshme.

Kështu pra, konstatojmë se ideja e eksplikimit të materializmit modern mbi kundërshtitë interiore dhe ideja e shkencës moderne mbi unitetin e komponimit interior të materies, kanë dy drejtime të kundërta në mes veti.

3. Ose, mendon se vetë veja prezenton dy kundërshtime me ekzistenca të pavarura. Gjatë gjendjes në brendësi grufullon njëra prej dy kundërshtive dhe formohet pula.

Ky lloj i grindjes në mes kundërshtive është i qartë dhe i vjetër në jetën e njeriut, por, pse ta quajmë reciprocitetin e komponenteve të brendshme kundërshti?

Pse ta quajmë reciprocitetin mes farës, dheut dhe ajrit kundërshti?

Pse ta quajmë reciprocitetin mes mitrës, embrionit dhe ushqimit kundërshti?

Kjo çështje është vetëm problem nominimi dhe do të ishte më mirë të thuhej se njëra me tjetrën bashkohen dhe asimilohen.

Edhe nëse e quajmë kundërshti, nuk do ta zgjidhim problemin derisa pranojmë se ky reciprocitet mes dy kundërshtive shkakton një rezultat më të madh, një proces evolutiv, risi numerike...

Prej nga vjen kjo shtojcë?

A ka ardhur prej të dy kundërshtive që eliminohen?

Nëse nuk e ke një gjë, nuk mund ta japësh.

Kjo ishte edhe një nga tri çështjet e cekura më parë.

A dimë diçka të tillë nga natyra?

Si mund të pranohet se kundërshtia e ndihmon kundërshtinë tjetër në bazë të grindjes, derisa dimë se grindja do të thotë refuzim dhe rezistencë?

Një grindje e tillë e dobëson palën e kundërt në vend që t'i japë ndihmë.

Të gjithë e dimë se notari kur ballafaqohet me valët e ujit, pengohet shumë dhe në rast të tillë, valët janë faktor i lëvizjes së tij.

Nëse grindja e kundërshtive është shkak kryesor i zhvillimit dhe shndërrimit të vesë në pulë, atëherë çka rezulton grindja mes kundërshtive gjatë procesit të shndërrimit të ujit në gaz dhe anasjelltas?

Natyra vetë na zbulon se grindjet shkaktojnë katastrofë e jo evolucion dhe progres.

Një grindje e tillë edhe në brendinë e atomit shkakton procese shkatërrimi të cilat e eliminojnë ekzistencën e materies, ndërsa energjitë shpërndahen në atmosferë.

Nga kjo që u tha më parë, konkludojmë se lëvizja e materies pa faktor eksterior nuk mund të zhvillojë evolucion të vërtetë, zhvillim më të lartë dhe më preciz.

Për ta përfituar materia jetën, ndjenjën dhe mendjen, ka nevojë për Zot që i posedon të gjitha këto karakteristika.

Materia luan rolin e mundësisë, përgatitjes dhe përshtatshmërisë, ashtu siç është fëmija i përgatitur për pranimin e mësimit nga mësuesi i tij.

I madhëruar është All-llahu, Zoti i botëve!

ATRIBUTET E ZOTIT TË MADHËRUAR

Kur besojmë në Urtësinë e Zotit si Krijues, Dirigjues dhe Sistemues i gjithësisë, natyrisht obligohemi t'i njohim atributet e Tij, duke u mbështetur në krijimin e Urtë dhe t'i vlerësojmë karakteristikat e Tij duke u mbështetur në krijesat e Tij, ashtu siç e vlerësojmë ndonjë inxhinier sipas projektit të tij artitektonik, shkrimtarin sipas librit të tij dhe edukatorin sipas suksesit të tij profesional.

Në këtë mënyrë mund të përfitojmë pasqyrë rreth diturisë, urtësisë, jetës, fuqisë, shikimit dhe dëgjimit të Krijuesit të Madhëruar.

Preciziteti i gjithësisë zbulon diturinë dhe urtësinë, energjitë dhe fuqitë në thellësinë e gjithësisë, format e ndryshme të jetës, shkallët e njohjes racionale dhe sensuale. Uniteti arkitektiv dhe projektiv argumentojnë fuqinë, mbizotërimin, jetën, njohurinë dhe njësinë e Zotit, Krijuesit.

DREJTËSIA DHE SINQERITETI I TIJ

Të gjithë ne pranojmë - me intelektin tonë instinktiv aksiomatik - parime të përgjithshme të sjelles që konfirmojnë se drejtësia është e vërtetë dhe e mirë kurse tirania e keqe dhe e humbur. Ai që vepron drejt respektohet dhe shpërblehet kurse me atë që vepron keq ndodh e kundërta.

Çdo njeri, nëse qëndron para dy alternativave: të mirës dhe të keqes, besnikërisë dhe tradhtisë, instinktivisht do ta zgjedh të mirën dhe besnikërinë, eventualisht nëse nuk ekziston ndonjë faktor ose interes personal që mund të shkaktojë devijim bihevoristik.

Njeriu, i cili nuk ka kurrfarë interesi personal nga tradhtia dhe tirania, sigurisht do të vepronte me sinqeritet, besnikëri, drejtësi apo sjellje të drejtë.

Krijuesi i Urtë e i Madhëruar i posedon të gjitha atributet të cilat mund t'i njohim me intelektin tonë instinktiv ngase Ai na ka dhuruar një intelekt të tillë.

Ai, me fuqinë dhe kompetencën e Tij në gjithësi, nuk ka nevojë për të zhvilluar negociata dhe intriga.

Prej këtu besojmë se Zoti i Madhëruar është i drejtë dhe nuk e dëmton askë.

DREJTËSIA E ZOTIT TË MADHËRUAR KONFIRMON NDËSHKIMIN

Virtytet të cilat i pranojmë sigurojnë drejtësi, sinqeritet, besnikëri kurse ato që i refuzojmë janë negative. Këto virtyte jo vetëm që i refuzojnë negativet por edhe kërkojnë ndëshkim adekuat.

Intelekti instinktiv dhe i shëndoshë e pranon dënimin e tiranit e të tradhtarit dhe shpërblimin e të drejtit besnik, i cili lufton për hir të së drejtës dhe besës.

Çdokush prej nesh, nga brendia e dënon tiraninë e devijuar dhe e shpërblen të drejtën e sinqertë dhe vetëm ndonjë pengesë mund ta pengojë për të ndërmarrë ndonjë hap të tillë.

Pasi që Zoti i Madhëruar është i drejtë, ka aftësi shpërblimi dhe ndëshkimi, dhe se asgjë nuk mund ta pengojë për të ndërmarrë një veprim të tillë, atëherë besojmë se Zoti shpërblen sipas mirësisë dhe ndëshkon sipas të keqes.

Por, në të njëjtën kohë vërejmë se një shpërblim i tillë zakonisht nuk realizohet në këtë jetë të tokës edhe pse është i aftë për një gjë të tillë.

Kjo gjë argumenton ekzistimin e ditës së shpërblimit, kur punëtori i panjohur, i cili ka luftuar për ndonjë qëllim të lartë, do të shpërblehet, kurse tirani që ka shpëtuar nga dënimi dhe ka jetuar nga gjaku i të dëmtuarve, do të dënohet në mënyrë të drejtë.

Kjo ditë është Dita e Kijametit (gjkimit), kur të gjitha virtytet bihevioriste do të personifikohen, për shkak se sikur të ndodhte e kundërta, të gjitha këto virtyte nuk do të kishin vlerë.

PEJGAMBERI

HYRJE E PËRGJITHSHME NË FENOMENIN E PEJGAMBERISË

Çdo gjë në këtë gjithësi përmban në vete ligj hyjnor preciz, në farë, ekziston ligji që brenda disa kushteve të caktuara e shndërron atë në dru kurse embrionin në njeri.

Dielli, protonet, yjet dhe elektronet lëvizin në një drejtim të caktuar dhe zhvillohen sipas mundësisë.

Ky sistemim hyjnor e ka përfshirë çdo fenomen dhe çdo anë të gjithësisë.

Tanimë është formuar fenomeni më i vlefshëm në gjithësi, fenomeni i mundësisë për zgjedhje, tek njeriu.

Njeriu është qenie zgjedhëse, dmth, është qenie që ka qëllim apo vepron për ta realizuar qëllimin e tij. Ai gropon tokën për të nxerrë ujë, e zien gjellën për ta bërë më me shije, e studion ndonjë fenomen natyror për ta njohur ligjin e tij, ndërsa ekzistencat tjera natyrore veprojnë sipas destinimeve të predestinuara, e jo për ta realizuar qëllimin e tyre personal: mushkëritë, lukthi dhe nervat kryejnë funksione fiziologjike.

Qëllimi i funksioneve të tyre nuk varet nga aktiviteti natyror fiziologjik sepse është qëllim i Krijuesit të Gjithëditur.

Pasi që njeriu është qenie internacionale, dhe se aksionet dhe sjelljet e tij janë në lidhshmëri me qëllimet e tij, atëherë konstatojmë se aksionet e tij praktike nuk janë të predestinuara me Ligj natyror preciz, ashtu siç bie pika e shiut sipas ligjit të gravitacionit, sepse në të kundërtën, nuk do të ishte qenie intencionale që funksionon për shkak të ndonjë qëllimi të lokalizuar në brendi.

Për të qenë njeriu qenie intencionale, obligohet të jetë i lirë e të lëviz sipas dëshirës së tij.

Lidhshmëria e aksioneve praktike me qëllimet e tij, prezenton ligjin që sistemon fenomenin e zgjidhjes së lirë.

Qëllimi i njeriut nuk është kaotik.

Çdonjëri i cakton qëllimet e tij sipas nevojave të interesit personal. Këtë nevojë e përcakton ambienti dhe rrethanat objektive të individit. Këto rrethana nuk e lëvizin njeriun në mënyrë direkte ashtu si i lëviz era gjethet e drurit, sepse në këtë mënyrë njeriu e humb rolin e tij si qenie intencionale.

Pra, rrethanat duhet ta lëvizin njeriun në përputhshmëri me të kuptuarit e njeriut, interesin e tij në ndonjë rast praktik të posaçëm.

Çdo interes nuk ndjell agjitacion tek individit por vetëm ai që është në favor të tij, ngase interesat ndahen në dy lloje:

1. Interes individual me afat të shkurtër, dhe

2. Interes shoqëror me afat të gjatë.

Pasi që shpeshherë konfrontohet interesi individual me atë shoqëror, vërejmë se njeriu nuk funksionon sipas vlerës pozitive të interesit por vetëm sipas dobësisë së tij personale.

Gjithashtu vërejmë, në anën tjetër, se krijimi i rrethanave objektive për sigurimin e lëvizjes së njeriut në interes shoqëror, është kusht i domosdoshëm për stabilitet dhe sukses afatgjatë në jetë.

Për shkak të këtij parimi, njeriu ballafaqohet me një kontrast mes interesit shoqëror për stabilizimin jetësor dhe mes interesit të tij personal.

Për këtë shkak, është ndier nevoja për zgjidhjen e këtij kontrasti dhe për formimin e rrethanave objektive që e lëvizin njeriun në interes të shoqërisë.

Pejgamberia, si fenomen hyjnor në jetën e njeriut, konsiderohet si zgjedhje për shkak se i shndërron interesat e shoqërisë, të cilat i tejkalojnë interesat e njeriut me afat të shkurtër, në interesa të njeriut me afat të gjatë., duke ua tërhequr vërejtjen se jeta vazhdon edhe pas vdekjes dhe se të gjithë do të transferohen në sheshin e drejtësisë e do t'i shohin veprat e tyre:

“E kush punoi ndonjë të mirë që peshon sa grimca, atë do ta gjejë. Dhe kush punoi ndonjë të keqe, që peshon sa grimca, atë do ta gjejë.” (Zelzele, 7-8).

Kështu pra, interesat shoqërore shndërrohen në interesa individuale, me afat të gjatë.

Ky solucion përbëhet nga teoria dhe praktika edukative.

Teori do të thotë: ringjallja në Ditën e Gjykimit, kurse praktika edukative prezenton direktivën hyjnore.

Kjo teori nuk mund të jetë gjë tjetër pos hyjnore sepse mbështetet në Ditën e Gjykimit apo në eskatologji.

Kjo teori, gjithashtu inspirohet nga qielli dhe quhet PEJGAMBERI.

Për këtë shkak, pejgamberia dhe ringjallja ballafaqohen me një formë të përbashkët që konsiderohet si zgjidhje e vetme e kontrastit në jetën e njeriut dhe si kusht kryesor për zhvillimin e teorisë së zgjedhjes së lirë në favor të interesave të vërteta të njeriut.

KONFIRMIMI I PEJGAMBERISË SË TË DËRGUARIT TË MADHËRISHËM, MUHAMMEDIT A.S.

Ashtu siç u argumentua Krijuesi i Urtë me argument induktiv dhe me metoda të induksionit shkencor, gjithashtu mund të argumentohet edhe pejgamberia e Muhammedit a.s. me argument shkencor induktiv dhe me metodat që i përdorim për argumentimin e të vërtetave të ndryshme në jetën tonë të përditshme dhe shkencore.

Të fillojmë një hyrje me këta shembuj:

Nëse njeriu pranon një letër nga ndonjë i afërt i tij që është fëmijë, nxënës i shkollës fillore fshatare, dhe vëren se letra është e shkruar me një gjuhë të re, me fjalë të sakta dhe jo të rëndomta, me stil të lartë artistik dhe me ide të sistemuara, pra, nëse pranon një letër të tillë, do të konkludojë se ndonjë njeri që ka kulturë dhe njohuri të gjerë, ekspresivitet të jashtëzakonshëm, i ka diktuar fëmijës apo diç ngjashëm me këtë.

Nëse duam ta analizojmë këtë konkludim dhe këtë argument, vërejmë se mund të ndahet në këto pika:

1. Shkruesi i letrës është fëmijë, fshatar dhe nxënës në shkollë fillore.
2. Letra dallohet me një stil artistik të lartë dhe me një radhitje të jashtëzakonshme të mendimeve.
3. Induksioni zakonisht argumenton në këto raste se një fëmijë me këto cilësi të cekura në pikën e parë nuk mund të shkruajë një letër të cilën e vërejtëm në pikën e dytë.
4. Nga kjo rezultojmë se letra është produkt i tjetërkujt dhe se fëmija, në ndonjë mënyrë ka mundur t'i regjistrojë në letrën e tij.

Të cekim argumentin shkencor me të cilin shkencëtarët e kanë argumentuar elektronin:

Disa shkencëtarë, gjatë studimit të disa rrezeve të formuara në epruvetë të mbyllur, e kanë ngjitur në mes të epruvetës një copë magneti në formë të potkoit dhe kanë vërejtur se rrezet anojnë kah poli pozitiv dhe largohen nga ai negativ.

Ky eksperiment është përsëritur në rrethana të ndryshme gjersa është vërtetuar se magneti i tërheq ato rreze, e posaçërisht poli pozitiv.

Shkencëtari, gjatë studimit të rrezeve, e ka ditur se magneti nuk ndikon në rreze ashtu siç nuk ndikon në dritë normale dhe se magneti i tërheq trupat e jo rrezet.

Kështu, pasi që ka qenë i bindur se nuk mund të eksplikojë një ngjarje të tillë në bazë të informatave të atëhershme, ka zbuluar një faktor të ri dhe një të vërtetë të re:

“Këto rreze formohen prej substancave precize negative dhe i kanë quajtur “elektrone”.

Në shembullin e letrës dhe të elektroneve, argumentimi mund të rezimohet kështu: çdoherë që vërehet ndonjë fenomen brenda faktorëve dhe rrethanave materiale dhe se induktivisht është zbërthyer se këta faktorë dhe rrethana materialiste në raste të njëjta nuk prezantojnë formë të ngjashme, atëherë konfirmohet ekzistenca e një faktori tjetër të padukshëm dhe të nevojshëm për eksplikimin e një fenomeni të tillë:

“Një ngjarje e tillë plotësisht e konfirmon peygamberinë e të dërguarit të madhërishtëm, Muhammedit a.s. dhe mesazhin që ia ka proklamuar botës në emër të qiellit.”

Argumenti fillon sipas pikave vijuese:

PIKA E PARË

Ky njeri që ia ka proklamuar mesazhin e tij botës në emër të qiellit, i përket Siujdhesës Arabe që konsiderohej atëherë si shembull i regresivizmit në lëmitë kulturore, ideologjike, shoqërore, politike dhe ekonomike, e veçanërisht pjesa e Hixhazit sepse kjo pjesë nuk ka patur asnjëherë ndonjë civilizim gjatë historisë së kaluar, por vetëm në vendet fqinje, qindra vite më parë.

Nuk ka patur ndonjë eksperiencë shoqërore, të përkryer e as ndonjë kulturë. Idhujtaria ishte në kulm kurse parimi fisnor mbizotëronte dhe luante rol të rëndësishëm në gati të gjitha aktivitetet.

Vendlindja e peygamberit nuk ka njohur ndonjë formë të jurisprudencës por vetëm atë që e ka vendosur fisi apo familja.

Fuqitë progresive dhe rrethanat ekonomike në atë pjesë të botës kanë qenë të prapambetura ashtu siç ishte rasti me rruzullin tokësor, bile edhe format më të thjeshta të kulturës - shkrimi dhe leximi - kanë qenë relative sepse pjesa dërrmuese e shoqërisë nuk i ka njohur:

“Ai është që arabëve të pashkolluar ua dërgoi peygamberin nga mesi i tyre që t’ua lexojë ajetet e Tij, t’i pastrojë ata, t’ua mësojë librin dhe sheriatin, edhe pse ata ishin më parë në një humbje të dukshme.” (El Xhumu’a, 2).

Personaliteti i peygamberit ishte normal, para peygamberisë nuk dinte shkrim e lexim si dhe nuk ka marrur mësim të rregullt ose të çrregullt:

“Ti (Muhammed) nuk ishe që lexon ndonjë libër para këtij, e as që shkruajsh atë me dorën tënde të djathtë, pse atëherë do të dyshonin ata të prishurit.” (Ankebut, 48).

Ky tekst kur’anor argumenton qartë nivelin e kulturës së peygamberit para peygamberisë, bile është argument kategorik edhe për atë që nuk e pranon hyjninë e Kur’anit.

Këtë tekst pra, e ka proklamuar peygamberi para popullit të vet dhe atyre më të autorizuarve në jetë dhe histori.

Askush nuk e ka kritikuar për atë që ka folur e as që e ka mohuar, bile as që ka dhënë ndonjë kontribut në aktivitetet kulturore të njohura në atë kohë: poezi, prozë, kurse privilegji i tij i vetëm ka qenë etik: besnik, i pastër, i singertë dhe i mëshirshëm.

Ka jetuar dyzet vjet para peygamberisë pa e vërejtur populli ndonjë gjë karakteristike pos biheviorit të pastër.

Gjithashtu nuk ka patur kurrfarë ide praktike për ndonjë ndryshim të madh, por, një ndryshim i madh ka ndodhur papritmas pas dyzet vjetëve të pastra:

“Thuaj: “Sikur të kishte dashur All-llahu, unë nuk do t’ua kisha lexuar juve atë as nuk u kisha njoftuar me te. Unë para tij kam jetuar një kohë në mesin tuaj (as nuk kam ditur as nuk kam lexuar), a nuk mendoni?” (Junus, 16).

Muhammedi a.s. u lind në Mekke dhe aty e ka kaluar jetën deri para peygamberisë. Jashtë Siujdhesës Arabe ka dalur vetëm dy herë, në dy udhëtime të shkurtra: udhëtimi i parë me xhaxhain e tij Ebu Talibin në fëmijëri, kurse i dyti me pasurinë e Hadixhes.

Për shkak të mosnjohjes së shkrimit dhe leximit, nuk ka patur mundësi t’i lexojë tekstet hebreje fetare dhe ato krishtere e as që ka ndikuar diçka nga rrethi sepse Mekka ka patur traditë idhujtare.

Arabët e Mekkes, të cilët e kanë refuzuar adhurimin e putave, nuk kanë qenë nën ndikimin e hebraizmit dhe krishterimit, bile as që kanë reflektuar diçka, siç ishte rasti me Ibën Saiden.

Peygamberi, sikur të ishte orvatur të lexojë diçka nga burimet e mendimit hebraik dhe krishter, do të binte në sy, sepse në një ambient të thjeshtë dhe me lidhje të prera ideologjike - krishtere dhe hebreje - nuk do të ishte vështirë të vërehej një gjë e tillë.

Gjurmët e lëvizjes dhe të marrëdhënieve lehtë vërehen.

PIKA E DYTË

Mesazhi i proklamuar në popull nga ana e Muhammedit a.s. - Kur’ani dhe sheriati islam - ka shumë karakteristika:

- Lloji i tij është i vetëm, ka zbritur nga kultura hyjnore, Zoti i Madhëruar, atributet, dituria, fuqia, cilësia e marrëdhënieve me njeriun, roli i profetëve në udhëzimin e njerëzve, uniteti i mesazhit të tyre, virtytet, idetë, lidhja e Zotit me të dërguarit e Tij, konflikti i vazhdueshëm mes të mirës dhe të keqes, drejtësisë dhe tiranisë, lidhja e fuqishme kontinuve e mesazheve qiellore me të meltretuarit dhe të dëmtuarit, kundërshtimi i përhershëm me pronarët e interesave jolegjislative...
- Kjo kulturë hyjnore nuk ka qenë më e madhe në shoqërinë idhujtare dhe putiste por ka qenë më e madhe se të gjitha kulturat fetare të njohura në atë kohë, bile çdo krahasim bën të qartë se misioni i tij ka qenë t’i korrigojë gabimet dhe devijimet e kulturave, si rikthimin e tyre në instinkt dhe intelekt të shëndoshë.

- E gjithë kjo i është shpallur njeriut ummij në një shoqëri idhujtare deri diku të izoluar, njeriut që nuk dinte asgjë nga kulturat dhe veprat fetare të kohës së tij.

Pra, a vjen parasysh të flitet për ndonjë ide ripërtëritëse dhe progresive?!

- Mesazhi hyjnor ka përmbajtur edhe virtyte jetësore, njerëzore, praktike, shoqërore, legjislative dhe juridike. Bile edhe mohuesit e hyjnisë së tij kanë pranuar se janë virtyte civilizuese dhe juridike më të çmuara në historinë njerëzore.

I biri i shoqërisë fisnore papritmas është paraqitur në skenën e teatrit botëror dhe historik për të thirrur unitetin njerëzor.

Ky është paraqitur për të shkatërruar shoqërinë diskriminuese që mbështetej në vlerësimin fisnor, familjar dhe autoritativ në shoqëri dhe ta mësojë shoqërinë se njerëzit janë të barabartë si dhëmbët e krahërit:

“Tek All-llahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur (nga të këqijat).”
(Huxhurat, 13)

- I biri i shoqërisë është paraqitur edhe për ta realizuar këtë mesazh, për ta përjetuar njerëzit, për ta lartësuar femrën që mbytej në pozitë përkatëse dhe për ta konsideruar të barabartë me mashkullin në humanizëm dhe fisnikëri.
- Në mesin e shkretëtirës që mendohej vetëm për disa probleme personale, për dëbimin e urisë, është paraqitur peygamberi për t’i udhëhequr në bartjen e përgjegjësisë më të madhe, të bashkuar në luftë për çlirimin e botës dhe për t’i shpëtuar të dëmtuarit në Lindje dhe Perëndim nga tirania e udhëheqësve.
- Në zbrazëtirën politike dhe ekonomike që shprehej në formë të kamatës, monopolizmit dhe shfrytëzimit, u paraqit i biri i shkretëtirës për ta plotësuar atë zbrazëtirë, për ta kompletuar sistemin, ligjin, marrëdhëniet shoqërore dhe ekonomike në shoqëri, për ta zhdukur kamatën, monopolizmin, shfrytëzimin, për ta shpërndarë pasurinë ashtu që shteti të mos jetë vetëm i të pasurve, për t’i proklamuar parimet e solidaritetit shoqëror, sigurimit shoqëror që i ka njohur përvoja njerëzore qindra vite më vonë.

Të gjitha këto ndryshime të mëdha kanë ndodhur gjatë një kohe relativisht të shkurtë, pra, shumë më shpejtë se sa lyp një ndryshim i tillë shoqëror.

Mesazhi, në shumë tekste kur’anore flet detajisht për historinë e profetëve dhe popujve të tyre, për ngjarjet dhe ndodhitë që nuk i ka ditur ambienti i tyre idhujtar dhe injorant.

Peygamberi a.s. ka patur qëndrim të guximshëm ndaj dialogjeve të hebrenjve dhe krishterëve.

Kur’ani e ka informuar për gjëra që nuk ka mundur Muhammedi a.s. t’i njohë më parë:

“E ti nuk ishe në anën perëndimore (të vendit ku All-llahu i foli Musait) kur Ne Musait ia besuam shpalljen (e bëmë peygamber dhe e dërguam te faraoni), e ti as nuk ishe aty pranë”.
(El Kasas, 44).

“Por ne krijuam popuj (mes Musait e teje Muhammed), e koha ka zgjatur (ndaj, të dërguam ty). Dhe ti nuk banove në mesin e popullit të Medjenit e t’ua lexosh këtyre argumentet tona

(lajmin për Musain, për Shuajbin, për vajzat e tij), por ne të dërguam (dhe të njoftuam).” (El Kasas, 45).

“Dhe ti nuk ke qenë pranë kodrës Tur kur ne e thirrëm (Musain), por (tregimi ynë) është mëshirë nga Zoti yt, për t’ia tërhequr vërejtjen një populli që para teje nuk i kishte ardhur ndonjë pejgamber, dhe ashtu ata të marrin mësim.” (El Kasas, 46).

Lexuesin e mahnit ajo se tregimet e vërteta në Kur’an nuk janë të kopjuara nga të dy dhjatat.

Nëse supozojmë se këto mendime kanë qenë të njohura në mesin e Pejgamberit, atëherë do të vërenim se roli i kopjimit do të ishte negativ dhe me karakter tregtar, apo siç thuhet “Jep e merr”., kurse roli i Kur’anit në rrëfimin e tregimit është pozitiv dhe korrektues, i korrigjon tregimet dhe i korrekton prej ndonjë ndryshimi eventual në te (që nuk pajtohet me instinktivitetin monoteist, intelektin e kthjellët dhe konceptimin fetar të shëndoshë).

Edhe mohuesit e hyjnisë së Mesazhit pranojnë se Kur’ani paraqet formën më të lartë të ekspresivitetit, stilistikës dhe formave tjera retorike dhe se është vijë demarkacioni mes dy periudhave të historisë së gjuhës arabe dhe faktor kryesor i ndryshimit stilistik gjuhësor.

Arabët, kur Muhammedi a.s. u fliste me Kur’an, e ndienin se nuk u ngjanë formave të njohura stilistike dhe retorike, gjersa njëri prej tyre ka thënë:⁷

“Pasha Zotin, kam dëgjuar fjalë që nuk u ngjajnë fjalëve të njerëzve e as të xhinëve..., dominon e nuk dominohet dhe destrukton çdo formë që është nën te.”

Nuk e kanë dëgjuar Kur’anin për shkak se janë frikësuar nga influenca dhe fuqia që shkaktonin ndryshim në shpirtat e tyre.

Kjo gjë argumenton veçorinë specifike të stilistikës kur’anore dhe refuzon idenë kinse Kur’ani është kontinuitet i traditës së zhvilluar.

Ata kanë humbur në garat e vazhdueshme me Muhammedin a.s., një herë shprehën paaftësinë e tyre të përpilojnë një vepër të tillë edhe nëse bashkohen, herën tjetër paaftësinë e tyre të përpilojnë dhjetë sure, kurse herën e tretë, paaftësinë e tyre ta përpilojnë edhe një sure të ngjashme me atë të Kur’anit.

Këtë gjë Muhammedi a.s. e pohonte në mesin ku njihej vetëm profesioni letrar, arti stilistik, përballimi i provokimeve dhe lavdidashësia, në mesin ku me mish e me shpirt orvateshin ta shuajnë dhe ta mbulojnë dritën e mesazhit të ri.

Pos kësaj, kjo shoqëri nuk e ka kritikuar Kur’anin për shkak se ka qenë e bindur se letërsia kur’anore dominon mbi fuqitë e saja filologjike dhe artistike.

Gjë e çuditshme është se transmetuesi ka qenë njeri i panjohur jo vetëm në letërsi por edhe në artet tjera stilistike, edhe pse ka jetuar në mesin e tyre dyzet vjet.

Këto janë disa karakteristika të Mesazhit që ia proklamonte Muhammedi a.s. botës.

⁷ El Velid ibnul Mugire

PIKA E TRETË

Në këtë pikë do të argumentojmë me induksion shkencor se ky mesazh, me këto karakteristika të studiura në pikën e dytë, janë rrethanat dhe faktorët e cekur në pikën e parë.

Historia e shoqërive ka regjistruar raste të shumta kur del ndonjë njeri para shoqërisë për ta udhëhequr, por, ne këtu nuk gjejmë një rast të ngjashëm për shkak të diferencave të mëdha:

Këtu hasim një progres të përgjithshëm në jetë, ndryshim radikal në virtytet njerëzore.

Shoqëria fisnore me kënaqësi në prezencën e Muhammedit a.s. e ka pranuar idenë e shoqërisë botërore kozmopolite, shoqëria totemiste e ka pranuar fenë monoteiste që i ka korrigjuar të gjitha fetë tjera monoteiste dhe i ka pastruar nga falsitetet dhe legjendat.

Shoqëria e zbrazët është shndërruar në shoqëri të plotë, dirigjuese dhe pioniere e civilizimit që e ka ndriçuar tërë botën.

Në anën tjetër, çdo progres i përgjithshëm në shoqëri, nëse është produkt i rrethanave dhe faktorëve materialë, nuk mund të jetë i papërgatitur, i papritur, pa ndonjë relacion me periudhat e mëparshme preparative dhe me ndonjë rrymë paraprirëse.

Vazhdon, zhvillohet dhe zgjat ideologjikisht dhe shpirtërisht derisa të formohet në brendësinë shoqërore udhëheqje e aftë për ta qeverisur dhe përparuar shoqërinë.

Një studim komparativ i historisë së proceseve progresive në shoqëritë e ndryshme, qartëson se çdo shoqëri fillon ideologjizimin në formë të farave të shpërndara në thelb të shoqërisë e pastaj bashkohen, formojnë rrymë ideologjike, përcaktohen gradualisht parimet e kësaj rryme dhe formohet në brendësi udhëheqja qeveritare gjersa të del në skenë si pjesë e popullit, pastaj konfrontohet me pjesën zyrtare të shoqërisë dhe në bazë të grindjes kjo rrymë zgjerohet deri në dominim.

Përkundrazi, shohim se Muhammedi a.s. sipas historisë së mesazhit të ri, nuk ka qenë hallkë zinxhiri, nuk ka prezentuar pjesë të rrymës; idetë, virtytet dhe mendimet nuk kanë patur rrënjë në thelb të shoqërisë ku ka jetuar ai.

Rryma e formuar nga grupi i muslimanëve të parë në kohën e pejgamberit ka qenë produkt i mesazhit dhe Udhëheqësit.

Ai nuk ka qenë faktor paraprirës i lindjes së mesazhit për ta gëzuar autoritetin e udhëheqësit.

Për këtë shkak gjejmë se diferenca mes dhënies së profetit dhe dhënies së ndonjë tjetrit nuk ka qenë vetëm diferencë në fazë, ashtu siç është diferenca mes një fare dhe tjetrës, formuese të rrymës së re, por ka qenë themelore.

Kjo gjë argumenton se Muhammedi nuk ka përfaqësuar pjesë të ndonjë rryme, po rryma e re ka dalur prej tij.

Sipas aspektit të tretë, historisa argumenton se nëse udhëheqja ideologjike, teologjike dhe shoqërore e ndonjë rryme të re koncentrohet në një qendër, me anë të lëvizjes së progresit ideologjik, shoqëror, specifik, patjetër të ekziston në atë qendër fuqi, kulturë dhe njohje që janë proporcionale me mënyrat e jetës së njerëzve, pastaj doemos të ekzistojë praktimin suksesiv që e ka zhvilluar dhe përcaktuar për ta udhëhequr atë rrymë.

Përkundrazi, Muhammedi a.s. vet e ka praktikuar udhëheqjen ideologjike, teologjike, shoqërore, pa e caktuar historia - si njeri ummij, nuk ka ditur shkrim e lexim, nuk ka ditur asgjë nga kultura e kohës së tij dhe fetë e mëparshme - për shkak të aspektit kulturor dhe për ndonjë praktikim hyrës në këtë funksion udhëheqës e të papritur.

Pas kësaj që u tha, arrijmë në pikën e katërt, ku ekziston eksplikimi i vetëm, i logjikshëm dhe i pranuar rreth kësaj çështjeje.

Të supozojmë se ekziston faktori plotësues pas rrethanave dhe faktorëve materialë.

Ky është faktori i inspirimit, peygamberisë dhe prezenton ndërhyrjen e qiellit në dirigjimin e tokës.

“Po kështu me urdhrin tonë Ne të shpallëm edhe ty shpirtin (Kur’anin). Ti nuk ke ditur çka është libri (Kur’ani) as ç’është besimi, por Ne atë e bëmë dritë me të cilën e vëmë në rrugë të drejtë atë që dëshirojmë prej robërve tanë. Në të vërtetë, edhe ti udhëzon për në rrugën e drejtë.” (Esh-Shura, 52).

ROLI I FAKTORËVE DHE NDIKUESVE

Komentimi i mesazhit sipas parimit të shpalljes dhe ndërhyrjes së qiellit në vend të faktorëve dhe rrethanave materiale nuk do të thotë anulim i ndikimit të këtyre faktorëve dhe rrethanave në mënyrë përfundimtare, por ndikimi i tyre ka qenë sipas rregullave të përgjithshme kozmologjike dhe shoqërore.

Ndikimi i tyre është përcjellës i ngjarjeve dhe në favor të suksesit të mesazhit ose në dëm të tij.

Mesazhi, në esencë është e vërtetë hyjnore, qëndron mbi kushtet dhe rrethanat natyrore, por, pas shndërrimit të tij në lëvizje, aksion kontinuiv ndryshues, mund të lidhet me rrethanat që e mbrojnë nga pasojat dhe ndërhyrjet.

Mund të thuhet, për shembull, se arabi, për shkak se ka ndier në vete humbje dhe shkatërrim gjatë materializmit të zotërave dhe idhullit të tij më të lartë në formë të gurit që e copëton në rast hidhërimi, ose në formë të ëmbëlsirës që e gëlltit në rast urie, e ka shtyer të mendojë për mesazh të vërtetë; ose mund të thuhet se mjerimi dhe varfëria në shoqërinë arabe, tirania dhe padrejtësia e shfrytëzuesve dhe e të pabesëve e kanë inkurajuar të nxit lëvizje të re që e lartëson flamurin e drejtësisë dhe e zhduk kapitalin me kamatë;

Pastaj, ndjenja fisnore ka luajtur rol të rëndësishëm në periudhën e mesazhit, qoftë lokale: grindja dhe konflikti mes fiseve të Kurejshit dhe mbrojtja e Pejgamberit nga armiqtë për shkak të përkatësisë së tij kurejshite; ose qoftë nacionale: ndjenjat e arabëve të jugut ndaj atyre të veriut; pastaj rrethanat e botës së shkatërruar dhe gjendja e vështirë e dy shteteve të mëdha: shteti romak dhe ai persian, në skenën botërore në atë kohë, i kanë preokupuar këto dy fuqi të mëdha dhe e kanë penguar intervenimin e tyre të shpejtë kundër lëvizjes së re në Siujdhesën Arabe.

Një gjë e tillë, nëse thuhet, është e logjikshme dhe ndoshta pranohet, por me një supozim të tillë eksplikohen ngjarjet e jo vet mesazhi.

MESAZHI - ISLAM

MESAZHI - ISLAMI

Mesazh është Islami, feja me të cilën Zoti xh.sh., e ka dërguar Muhammedin a.s. si mëshirë për botët.

Qëllimi i Islamit, para së gjithash, prezenton lidhshmërinë e njeriut me Zotin e tij dhe me ringjalljen. Sipas aspektit të parë, njeriu formon lidhshmëri me Zotin e vetëm, të vërtetë dhe që e pranon instinkti, konfirmon njësinë e Zotit të vërtetë me bindshmëri për t'i eliminuar të gjitha llojet e zotërave artificialë, derisa frazën monoteiste: “Nuk ka Zot tjetër përveç Allahut”, e ka mëvetësuar si emblemë kryesore.

Pasi që peygamberia është ndërmjetëse e vetme dhe e drejtpërdrejt mes krijesës dhe Krijuesit, atëherë dëshmia për njësinë e Zotit krijues dhe lidhshmëria me Zotin e vërtetë konsiderohen si parime të mjaftueshme për konfirmimin e monoteizmit.

Sipas aspektit të dytë, njeriu formon lidhshmëri me ringjalljen për ta kompletuar mënyrën e solucionit të vetëm të problemit të kontrastit, dhe për ta realizuar në të njëjtën kohë edhe drejtësinë hyjnore, ashtu siç u cek më parë.

Mesazhi islam i ka karakteristikat dhe shenjat që e dallojnë nga mesazhet tjera të qiellit dhe e pëcaktjnë si ngjarje të vetme në histori.

Në vijim do të cekim shkurtimisht disa prej tyre:

1. Ky mesazh ka ngelur në tekstin kur'anor i shëndoshë, pa kurrfarë falsiteti, kurse librat tjerë të hershëm hyjnorë janë falsifikuar në brendësi.

Zoti i Madhëruar thotë:

“Ne e kemi zbritur Kur'anin dhe Ne do ta mbrojmë.” (El Hixhr, 9).

Mbrojtja e përmbajtjes së besimit dhe jurisprudencës së mesazhit janë shkaqe të kontinuitetit të rolit të tij edukativ.

Çdo mesazh që humb një përmbajtje të tillë për shkak të falsifikimit dhe humbjes, nuk është adekuat për të formuar lidhshmëri mes njeriut dhe Zotit të tij, sepse një gjë e tillë nuk realizohet vetëm me përkatësi formale por me një lidhshmëri dhe aplikim të përmbajtjes në mënyrë ideologjike dhe bihevoriste.

Për këtë shkak, varësia e sigurimit të mesazhit islam nga sigurimi i tekstit kur'anor konsiderohet si kusht i domosdoshëm për kontinuitetin e qëllimeve të mesazhit.

2. Kontinuiteti tekstual dhe shpirtëror i Kur'anit, do të thotë se pejgamberia e Muhammedit a.s. nuk e ka humbur mjetin më të vlefshëm konfirmues. Kur'ani me parimet e mesazhit dhe të shariatit, janë argumente induktive, ashtu siç u cek më parë, mbi ejgamberinë dhe dërgimin e Muhammedit a.s.

Ky argument vazhdon derisa të ekzistojë Kur'ani.

Pejgamberitë që konfirmohen me ngjarje të posaçme, përkundrazi, ndodhin dhe përfundojnë në një çast si psh. shërimi i të verbërit, gurbulanit, dhe këto ngjarje i shohin zakonisht vetëm bashkëkohanikët. Me kalimin e kohës dhe të shekujve, zhduken dëshmitarët e parë dhe humbet çdo argumentim kategorik sipas aspektit të hulumtimit të gjurmimit.

Për çdo pejgamberi të paargumentuar, Zoti nuk na obligon t'i besojmë ose ta konfirmojmë:

“E All-llahu nuk ngarkon askë, vetëm aq sa i ka dhënë;” (Talak, 7).

Ne sot u besojmë profetëve të kaluar (mëshira e Zotit qoftë mbi ta) duke u mbështetur në rrëfimet e Kur'anit.

3. Siç u pa, kalimi i kohës nuk e pakëson vlerën e argumentit themelor të mesazhit islam por vetëm kjo nuk mjafton.

Ky argument përfiton horizonte të reja gjatë progresit të njohjes njerëzore dhe studimit shkencor e empirist të gjithësisë.

Por edhe kjo nuk mjafton, sepse vet Kur'ani i ka paraprirë një drejtimi të tillë, i ka lidhur argumentet mbi ekzistimin e Krijuesit të Urtë me studimin dhe hulumtimin e thellësive të gjithësisë, ia ka tërhequr vërejtjen njeriut për sekretet dhe dobitë që i përmban një studim i tillë.

Njeriu modern, sipas asaj që gjendet në librin që i është shpallur njeriut ummij në një shoqëri injorante para qindra viteve, gjenë informata të qarta që i ka zbuluar sot shkenca moderne.

Për këtë shkak, orientalisti anglez Agneri, profesor i gjuhës arabe në Universitetin e Oksfordit, kur shkenca e ka zbuluar rolin e erërave në polenizim, ka thënë:⁸

“Pronarët e deveve veç e kanë ditur se era i polenizon drunjtë dhe frytet disa shekuj para se ta zbulojë shkenca atë në Evropë”

4. Ky mesazh i përmbledh të gjitha aspektet e jetës dhe për këtë shkak ka mundur t'i balancojë aspektet e ndryshme, t'i bashkojë e t'i unjësojë në një formë të plotë të gjithë: bashkuesin me bashkësinë, punën me frytin...

⁸ Këtu profesori aludon në ajetin e Kur'anit: *“Ne i lëshojmë erërat mbarësuese (polenizuese).”* (El Hixhr, 22)

Njeriu më nuk e ndanë jetën e tij shpirtërore nga ajo materiale.

5. Ky është i vetmi mesazh që ka korrur sukses të mahnitshëm në kohën e dërguesit dhe i ka shndërruar parimet e proklamuar në të vërteta të jetës së përditshme njerëzore.
6. Ky mesazh, gjatë periudhës së praktikimit ka hyrë në histori dhe ka ndihmuar në formimin e saj sepse ka qenë gurëthemeltar për formimin e popullit që e mbanë atë dhe ndriçohet me udhëzimin e tij.

Pasi që ky mesazh është hyjnor, prezenton dhuratë qiellore për tokën dhe është mbi logjikën e faktorëve dhe ndikimeve materiale, atëherë rezultohet lidhshmëria e historisë së kësaj shoqërie me faktor metafizik dhe me parim transcendent qe nuk u nënshtrohen rregullave materiale të historisë.

Për këtë shkak, do të gabonim nëse e kuptojmë historinë tonë vetëm në bazë të ndikimeve dhe faktorëve materialë ose e konsiderojmë si rezultat i rrethanave materiale ose i zhvillimit të forcave prodhuese.

Ky nocion materialist i historisë nuk dakordohet me një shoqëri që e ka themeluar ekzistencën e vet në bazë të mesazhit të qiellit, dhe nëse nuk e pranojmë këtë mesazh si të vërtetë hyjnore, atëherë nuk do të mund ta kuptojmë historinë e saj.

7. Ky mesazh nuk është përqëndruar vetëm në formimin e kësaj shoqërie, por është zgjeruar për t'u formuar si faktor dhe ndikues në mbarë historinë e botës.

Disa studiues korrektë evropianë ende pranojnë se civilizimi islam i ka zgjuar popujt evropianë nga gjumi dhe i ka udhëzuar.

8. Pejgamberi i dërguar me këtë mesazh, është dalluar nga të gjithë profetët e mëparshëm sepse mesazhi i tij është përfundimtar.

Ideja e pejgamberisë përfundimtare ka dy kuptime:

1. Kuptimi i parë është negativ dhe mohon paraqitjen e ndonjë pejgamberie tjetër në skenë, dhe
2. Kuptimi i dytë është pozitiv dhe konfirmon kontinuitetin e pejgamberisë përfundimtare dhe vazhdimin kohor.

Kur e analizojmë kuptimin negativ të pejgamberisë përfundimtare, gjejmë se është plotësisht në pajtim me realitetin gjatë katërmbëdhjetë shekujve të shpalljes së Islamit dhe do të jetë në pajtim me të aq sa do të zgjasë koha.

Nuk paraqitet një pejgamberi tjetër në skenën e historisë jo për shkak të largimit të saj nga roli themelor i parimeve të historisë njerëzore, por për shkak se pejgamberia përfundimtare ka ardhur me mesazhin e trashëguar, i cili i formulon të gjitha mesazhet në historinë e pejgamberisë dhe i përmbledh të gjitha vlerësimet stabile që gjenden në ato pejgamberi dhe mesazhe, pa vlerësime periodike.

Për këtë shkak ky mesazh ka qenë i aftë dhe i fuqishëm për kontinuitet përballë ndikimit të kohës dhe faktorëve të progresit dhe reformës:

“Ne dhe ty (Muhammed) ta zbritëm librin (Kur’anin) e vërtetë që është konfirmues i librave të mëparshëm dhe garantues i tyre.” (El Maide, 48).

9. Urtësia hyjnore e cila e ka përfunduar peygamberinë me Muhammedin a.s., ka përcaktuar të rekomanduar të cilët do t’i kryejnë detyrat e udhëheqjes dhe hilafetit pas përfundimit të peygamberisë. Ata janë dymbëdhjetë imamë.
10. Në rast të mungesës së imanit të dymbëdhjetë, shpëtimi i Zotit qoftë mbi të, Islami i drejton njerëzit kah fukahatë dhe kah hapja e derës së ixhtihadit, që do të thotë: përpjekje individuale për deduktimin e rregullave të shariatit nga Kur’ani dhe Sunneti.

10. Muharrem, 1397/h,
Nexhef
Muhammed Bakir Sadër

MUHAMMED BAKIR SADRI

Revolucionari i njohur dhe dijetari kozmopolit Muhammed Bakir Sadër u lind në vitin 1932 në qytetin Kadhimijje të Irakut.

Që nga fëmijëria është dalluar me gjenialitet dhe aftësi intelektuale.

Në moshën katërvjeçare e ka përjetuar vdekjen e prindit të tij dhe, për fat të keq, nuk ka mundur të mësojë nga ai, sepse i ati i tij Hajdar Sadër ka pasur njohuri të lartë në lëndën e Usulu Fikhut.

Kështu, përgjegjësia e edukimit të tij i ka ngelur së ëmës, Kerime esh-Shejhit dhe vëllait më të madh, Ismail Sadrit, të njohur në shkencat islame, e veçanërisht, sikur i ati, në lëndën e Usulit.

Muhammed Bakir Sadri mësimet e para edukative e arsimore i mësoi në shkollat shtetërore, kurse ato fetare dhe islame tek e ëma dhe vëllai.

Mësuesi i tij i gjuhës arabe, duke u bazuar në aftësinë intelektuale të Sadrit, ka thënë: “Pasha Zotin, sikur të ekzistonte qeveri që e vlerëson gjenialitetin dhe aftësinë e tij, do t’i jepte diplomën e shkollës së mesme dhe do t’ia hapte dyert e fakulteteve!”

Në moshën dhjetëvjeçare Sadri i kishte përvetësuar bazat e shkencave islame, kurse në atë njëmbëdhjetëvjeçare e kishte mësuar edhe logjikën.

Në moshën trembëdhjetëvjeçare, pas emigrimit në Nexhef, filloi të merret me studime të larta dhe para moshës njëzetvjeçare e arriti edhe gradën e muxhtehidit.

Shejh Abbas Rumejhi, për shkak të njohurisë së gjerë të Sadrit, ia ndaloi imitimimin dhe e obligoi me detyrën e ixhtihadit.

Ngjarjet politike, ideologjike dhe shkencore nuk e lanë të qetë asnjëherë, sepse ka qenë nxitës i Lëvizjes Islame në Irak, përtëritës i ndjenjave dhe i vetëdijes islame, si dhe martir i idesë revolucionare.

Maltretimet e mëdha filluan që nga viti 1968, atëherë kur në pushtet erdhi qeveria e Saddam Husejnit.

Është burgosur tri herë me radhë gjatë viteve 1972, 1977 dhe 1979.

Pas suksesit të Revolucionit Islam në Iran, më 1979, qeveria irakiane, nga frika se mos po i bashkangjitet edhe Lëvizja e Sadrit asaj iraniane, e arrestoi në prill të vitit 1980.

Saddami me thirrje telefonike i ka urdhëruar anëtarët e organeve të sigurimit irakian që t'ia dërgojnë në pallatin e tij republikan, ku pas një dialogu të shkurt e të rrept, e vrau me një plumb.

Veprat kryesore të tij janë:

1. Ekonomia jonë;
2. Filozofia jonë;
3. Islami udhëheq jetën;
4. Ligjërata në Usul;
5. Banka pa kamatë në Islam;
6. Bazat e logjikës induktive;
7. Hyrje filozofike në parimet islame;
9. Apelet;
10. Shkolla Kur'anore.

Muhammed Bakir Sadri ka vdekur, por Saddami ende jeton i ballafaquar me idetë sadriane revolucionare islame...

Muhamed Mustafa

